

Dëlirje Edukim

QERSHOR 2010 | XHUMADA AL-AHIR - REXHEB 1430 | NR. 14 | ÇMIMI 10

REVISTË MUJORE FETARE EDUKATIVE KULTURORE SHKENCORE

A ekzistojnë Fantazmat?

"Zemra, si një krijesë e Zotit, duhet të furnizohet çdoherë me ushqim dhe mbështetje të fortë. E, nëse ajo nuk ushqehet me ushqimin që Allahu ka caktuar për të, domethënë me besimin e pastër dhe bindjen ndaj Tij, ajo doemos do të ushqehet me ide, bindje e ideologji të gabuara, të cilat e shkatërrojnë dhe e zhysin thellë në zjarrin e skëterres." | fq. 7

- DISA GABIME NË EDUKIMIN E FËMIJËVE | fq. 22
- POZITA E GRUAS NË XHENNET | fq. 28



Kryeredaktor:
Zejd Haziri

Anëtarët e revistës:
Unejs Murati
Fidan Xhelili
Xheladin Leka

Bashkëpunëtorët:
Adem Avdiu
Muhamed Abdullahi
Sabahudin Selimi
Bali Sadiku
Lirim Sadiku
Namik Vehapi

Redaktor gjuhësor:
Arian Koçi

Redaktor Teknik:
Avni G. Gashi

Ballina/Dizajni:
Avni G. Gashi

Boton:
Shtëpia botuese
Atik

Gjilan, Republika e Kosovës

Tirazhi: 1000

Adresa:
Rr. M. Idrizi p.n 60000 Gjilan
Republika e Kosovës
Tel: 044 988 400
e-mail:
delirjedheeducim@gmail.com

Ndihmo Revistën:
Nr. i llog.: 1150-138922-0101-09
ProCredit Bank of Kosovo
Swift Code: MBKORS22
Gjilan, Republika e Kosovës

EDITORIALI

Xheladin Leka

A ekzistojnë fantazmat?! 2

Unejs Murati

Këshilla të qarta për zemra të pastra 4

Lirim Sadiku

E kundërta e tevhidit uluhije 6

Dr. Muhamed ibën Abdulvehab El Akil

Besimi në Melaike (III) 10

Darul Vatan

Dashuria për Allahun 18

Laura Ferati, Norvegji

Disa gabime në edukimin e fëmijëve (I) 22

Shuajb Rexha

Shpjegimi i hadithit: "Pretenduesi i diçkaje duhet të sjellë fakt vërtetues, ndërsa refuzuesi (pala e akuzuar) mjafton të betohet" 25

Jeton Bozhilani

Pozita e gruas në xhennet 28

Xhabir Sheme

Disa çështje në lidhje me akikën 32

Muhna Naim Nexhem Ebul Harith

Çfarë kuptojmë me termin "Selefi" 37

Namik Vehapi

Trashëgimia në Islam 41

Dr. Ibrahim ibën Amër er Ruhajli

Këshillë për të rinjtë selefi (I) 46

Dr. Abdullah ibn Umer ibn Muhammed Es-Suhejbanij

Vizita e varrezave të jobesimtarëve 50

Sabahudin Selimi

Imam Ahmedi ibën Hanbeli - Allahu e mëshiroftë 55

A EKZISTOJNË FANTAZMAT?!

Zemra, si një krijesë e Zotit, duhet të furnizohet çdoherë me ushqim dhe mbështetje të fortë. E, nëse ajo nuk ushqehet me ushqimin që Allahu ka caktuar për të, domethënë me besimin e pastër dhe bindjen ndaj Tij, ajo doemos do të ushqehet me ide, bindje e ideologji të gabuara, të cilat e shkatërrojnë dhe e zhysin thellë në zjarrin e skëterrës.

Kur zemra e njeriut ka besim të mangët apo është e zbratur tërësisht nga besimi, patjetër që do të ushqehet me ide, bindje e iluzione të kota për t'u menduar dhe shkatërrimtare për t'u besuar. Zemra, si një krijesë e Zotit, duhet të furnizohet çdoherë me ushqim dhe mbështetje të fortë. E, nëse ajo nuk ushqehet me ushqimin që Allahu ka caktuar për të, domethënë me besimin e pastër dhe bindjen ndaj Tij, ajo doemos do të ushqehet me ide, bindje e ideologji të gabuara, të cilat e shkatërrojnë dhe e zhysin thellë në zjarrin e skëterrës. Bindje të tilla të gabuara janë të shumta në mesin

e muslimanëve, saqë disa prej tyre bien në gjumë dhe zgjohen, hanë dhe pinë, rrinë me njerëz dhe vetmohen duke qenë gjithmonë në ëndrra, të cilat i kanë larguar aq shumë nga realiteti, saqë besojnë që çdo gjë në këtë botë është fantazmë dhe ëndërr. Këta njerëz shohin ëndrra në mes të ditës, atëherë kur dielli është në kupë të qiellit. Nga këto bindje të gabuara është edhe besimi në fantazma, i cili ka kapluar shumë zemra muslimanësh, ka hutuar shumë mendje, saqë në shumë faqe dhe forume interneti kohët e fundit është bërë debat kryesor. Debate dhe biseda të tilla janë bartur në popull përherë, mirëpo tani

me një ritëm më të madh.

Allahu e ka plotësuar fenë e Tij dhe u ka sqaruar muslimanëve çdo gjë që ka të bëjë me fenë e tyre, prandaj është obligim për çdo musliman që të hulumtojë edhe për këtë temë në Kur'an apo në fjalët e Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem - posaçërisht kur kjo temë është në çështjet e besimit- dhe jo të qëndrojë duarkryq para këtyre ideve dhe të tjerët të hedhin mbi të çtë dëshirojnë, si të ishte ai kazan mbeturinash.

Allahu na ka treguar në Kur'anin Fisnik se ka krijuar përveç njerëzve edhe një krijesë tjetër, që quhet exhin, ose xhind siç njihet në popull. Njeriu dhe xhinët janë ngarkuar me detyrime fetare, por asnjëherë nuk është thënë në Kur'an që ekzistojnë disa krijesa të tjera përveç këtyre, të cilat kanë mundësi të bëjnë dëm apo dobi.

Edhe më larg të vërtetës është fakti që disa mendojnë se këto fantazma janë shpirtira të njerëzve të vdekur, të cilët personifikohen te të gjallët që t'u bëjnë ndonjë dëm apo t'i largojnë nga ndonjë e mirë.

Këto ideologji nuk kanë vend në Islam dhe nuk i pranon logjika e shëndoshë, ngase shpirtirat e të vdekurve nuk kanë mundësi të kontaktojnë me të gjallët; ata e kanë përfunduar misionin e tyre në këtë jetë dhe kanë kaluar në jetën tjetër, në jetën e varrit, kështu që lidhja e tyre me botën është ndërprerë tërësisht. Këta shpirtira që jetojnë jetën e varrit, nëse kanë qenë të mirë në këtë botë, do të përgëzohen vazhdimisht me mirësi momentale në jetën e varrit dhe pastaj kjo mirësi do t'u shtohet edhe trupave të tyre, pasi trupi do t'i bashkëngjitet shpirtit në xhennet, ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Nëse kanë qenë të këqij në këtë botë, atëherë do të vuajnë vazhdimisht derisa të ringjallen dhe të futen në xhennem, ku do të shijojnë dënimin e merituar, me trup dhe shpirt.

Nga gjërat elementare të besimit te çdo musliman është besimi dhe bindja tij e thellë se askush nuk mund të bëjë dëm e as dobi përveçse me

ndihmën dhe caktimin e Allahut. Pasi na ka treguar që djalli i mallkuar është armik i përbetuar i njeriut, Allahu po ashtu na ka treguar që kurthet dhe komplotet e tij ndaj njeriut janë të dobëta, sidomos kur janë drejtuar kundër ndonjë besimtarit të devotshëm, prandaj edhe frika nga fantazmat e supozuara është frikë nga hiçi, frikë nga i dobëti, i marri, i cili nuk ekziston fare. Por edhe sikur të ekzistonte, nuk do të kishte pasur mundësi të bënte asnjë të keqe, nëse njeriu mbështet tek Allahu me mbështetje të vërtetë. Atyre të cilëve u duket se u shfaqen gjëra të tilla duhet ta dinë që ato gjëra nuk ekzistojnë fare, por janë vetëm lodra nga lodrat e djallit të mallkuar, përmes të cilave mundohet t'u a Humbë drejtimin dhe qëllimin e jetës këtyre personave dhe kështu të bëhen pesimistë për punë të mira duke u frikësuar gjithmonë nga ndonjë e keqe që do t'i godasë.

Allahu i urdhëron muslimanët që të jetojnë me realitetin, të jenë vigjilentë dhe syçelë, të përpiqen vazhdimisht për punë të mira. Allahu thotë: ***“Thuaj: “Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do ta shohin punën tuaj.”*** (Tevbe: 105) Ky është urdhri i Allahut për besimtarët, që ata të punojnë, të jetojnë jetën dhe të largohen sa më shumë nga intrigat e djallit të mallkuar, ngase fantazmat janë rrugë e djallit, të cilat përfundojnë në çmenduri e pastaj në xhennem, kurse rruga e Allahut do mund, sakrificë, punë, por ofron garanci për këtë botë dhe xhennet për botën tjetër.

Në emër të redaksisë:

Xheladin Leka

KËSHILLA TË QARTA PËR ZEMRA TË PASTRA



Këshilla është e shtrenjtë. Kush e merr atë, ka fituar dhe kush e refuzon dhe largohet nga ajo, ka humbur dhe devijuar. Duke parë gjendjen reale të muslimanëve po shkruaj këtë këshillë, duke e filluar këshillën nga vetja ime e pastaj edhe për ju, duke thënë se kjo që po ndodh sot tek muslimanët nuk del nga dy korniza apo dy gjëra.

Falënderimi i takon Allahut, të vetmit që meriton adhurim. Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili e këshilloi ummetin, largoi mjegullën dhe errësirën, e kumtoi ftesën dhe nuk la asnjë vepër që është në pëlqimin e Allahut dhe na çon drejt xhenetit

pa na lajmëruar dhe drejtuar drejt saj. Nuk ka punë që na afron tek urrejtja e Allahut dhe xhehennemi që të mos na ketë këshilluar të ruhem i prej saj. Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Feja është këshillë.” E pyetën: “Për kë, o i Dërguar i Allahut? Tha: “Për Allahun, librin e Tij, të Dërguarin e Tij, për udhëheqësit e musli-

manëve dhe për njerëzit e rëndomtë.”

Hasan el Basri thotë: “Kanë thënë disa nga shokët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “*Pashë Atë, në dorën e të Cilit është jeta ime, nëse doni, do të betohem tek Allahu se njerëzit më të dashur për Allahun janë ata që e bëjnë të dashur Allahun te njerëzit, që i bëjnë robërit e Allahut të dashur tek Ai dhe shpërndahen në tokë duke këshilluar.”*

Këshilla është e shtrenjtë. Kush e merr atë, ka fituar dhe kush e refuzon dhe largohet nga ajo, ka humbur dhe devijuar. Duke parë gjendjen reale të muslimanëve po shkruaj këtë këshillë, duke e filluar këshillën nga vetja ime e pastaj edhe për ju, duke thënë se kjo që po ndodh sot tek muslimanët nuk del nga dy korniza apo dy gjëra.

E para: Injoranca.

E dyta: Qëllimi negativ.

Injoranca është pengesë e të kuptuarit drejtë të fjalëve të thëna e pastaj transmetim i tyre te të tjerët në mënyrë të gabuar.

Qëllimi negativ i ndryshon gjërat dhe i paraqet sipas epsheve të veta dhe në bazë të saj krijon edhe raporte të këqija, që janë rezultat i qëllimit negativ të tij.

Si rezultat i injorancës së madhe dhe qëllimit negativ ndodhin pastaj edhe gjykimet joreale dhe të padrejta ndaj të tjerëve. Ajo që me të vërtetë i shpon zemrat dhe i bën sytë të lotojnë është se shumë nga pasuesit e Sunnetit i kanë këto cilësi.

Pasues i Sunnetit nuk do të thotë të kesh besim të pastër në Allahun, por duhet të

kesh edhe moral të lartë, që është plotësim i termit pasues i Sunnetit apo selefi. Edukata është pjesë e metodës së selefëve dhe Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: “*Jam dërguar të plotësoj virtytet e moralit.”*

Dr Muhamed Musa Naser ka thënë se shejtani te pasuesit e Sunnetit apo selefitë nuk ndërhyt në çështjet e besimit, por më shumë në çështje morale dhe etike.

Këshilla ime është që si pasues të Sunnetit të jemi nga ata që e praktikojmë atë në jetën tonë të përditshme.

Këshilla ime është që kush dëgjon ndonjë fjalë për dikë, ta marrë atë me kuptimin më të mirë dhe nëse nuk gjen tek ajo fjalë kuptim të mirë, atëherë të pyesë thënësin e asaj fjale për qëllimin e saj.

Këshilla ime është që kujt i arrin ndonjë fjalë, ta vërtetojë atë e mos të mjaftohet duke thënë se personi që ma ka thënë këtë është besnik. Këshilla ime është që për çdo fjalë që dëgjohej, të mos zmadhohet e të bëhet objekt i çdo bisede e të kalojë pastaj në thashetheme e të bëhet edhe padrejtësi.

Këshilla ime është që të kemi frikë Allahun në çdo çështje, të hapurat apo të fshehurat, të pëlqyerat apo të urryerat, të kapemi pas Sunnetit të të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, të largohemi nga risitë, mëkatet dhe veprat e urryera. Falënderimi i takon Zotit të botëve.

Unejs Murati

E KUNDËRTA E TEVHIDIT ULUHIJE

Shirku i vogël është një lloj dyfytërsie që hyn në veprë; vepra është për qëllim të bëhet për Allahun e Lartësuar, pastaj ndryshon në dyfytërsi apo syfaqësi, e cila e prish atë veprë. Allahu i Lartësuar thotë: “Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!” Kehf: 110

Falënderimi i takon Allahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu, s’ka kush e devijon dhe kë e largon nga rruga e vërtetë Ai, s’ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s’ka hyjni tjetër përveç Allahut, që është një, dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

Fjala më e mirë është fjala e Allahut, kurse udhëzimi më i mirë, udhëzimi i Muhamedit. Veprat më të këqija janë ato të shpikurat, prandaj çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është lajthitje nga rruga e vërtetë, kurse çdo lajthitje përfundon me xhehennem.

Robër të Allahut!

Numrin e kaluar treguam se tevhidi uluhije është të veçuarit e Allahut të Lartësuar në ibadet me të gjitha llojet e tij të dukshme apo të fshehta, qoftë fjalë apo veprë dhe mohimi i adhurimit të diçkaje apo dikujt me Allahun. Pra detyrë për çdo besimtar është të besojë me bindje të plotë se vetëm Allahu i Madhëruar meriton të adhurohet dhe askush tjetër përveç Tij, se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, sepse Allahu i Madhëruar është Ai i vërteti që meriton të adhurohet, ndërsa çdokush tjetër që adhurohet përveç Tij është i kotë, kushdo e çfarëdo qoftë, siç thotë Allahu i Lartësuar: “Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij” Isra: 23

Thotë Allahu i Lartësuar: *“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim).”* Nisa: 36

Pas gjithë kësaj vetvetiu shtrohet pyetja: Cila është e kundërta e këtij tevhidi?

Robër të Allahut!

E kundërta e tevhidit të adhurimit “tevhidit uluhije”, është shirku. Gjëja më e madhe që Allahu i Lartësuar na e ka ndaluar është shirku, d.m.th. t’i lutesh dikujt tjetër veç Allahut ose bashkë me Të. Kjo ndalesë kaq e fortë për shirkun është sepse ai kundërshton tevhidin uluhije dhe është padrejtësia më e madhe ndaj Allahut të Lartësuar dhe gjynahu më i madh që bën njeriu.

Allahu i Lartësuar thotë: *“Vërtet shirku është mizoria më e madhe.”* Lukman: 13

I Dërguari i Allahut thotë: *“Gjynahu më i madh është t’i bësh shok Allahut kur Ai ju krijoi.”* [1]

I Dërguari i Allahut thotë: *“Kushdo që vdes duke iu lutur dikujt tjetër veç Allahut, do të futet në zjarr.”* [2]

I Dërguari i Allahut thotë: *“Kush e takon Allahun pa i shoqëruar Atij ndonjë gjë në adhurimin e Tij, do të futet në xhennet dhe kush e takon Atë duke i shoqëruar Atij në adhurimin e Tij ndonjë gjë, do të futet në zjarr.”* [3]

Shirku është nëna e mizorisë, kurse tevhidi është nëna e drejtësisë. Shirku është mur-tajë për atë që e punon si në dunja ashtu edhe në ahiret, ndërsa tevhidi është shërim

në këtë botë, shpëtim në ahiret.

Robër të Allahut!

Shirku është dy llojesh:

a) Shirku i madh, i cili mohon tërësisht tevhidin uluhije dhe e nxjerr njeriun nga Islami dhe vepruesi i tij hyn në zjarr përgjithmonë, nëse nuk pendohet nga ai. Dihet se mushrikët bënë shirk në tevhidin e adhurimit, uluhije, sepse adhuronin tjetërkënd me Allahun e Lartësuar. Allahu i Lartësuar na urdhëroi: *“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim).”* Nisa 36

b) Shirku i vogël, i cili nuk e largon njeriun nga Islami, por ia pakëson dhe e bën këtë tevhid të mangët. Shirk i vogël konsiderohet edhe çdo veprim ose thënie që njihet nga sheriat si shirk, por që nuk e nxjerr personin nga Islami.

Robër të Allahut!

Njeriu duhet ta dijë çfarë është shirku i madh e i vogël.

Shirku i madh është kur robi i bën Allahut të Lartësuar shok në adhurim (uluhije) dhe e konsideron këtë të barabartë me Zotin e gjithësisë, e do atë siç duhet Allahu, i frikësohet siç ia ka frikën Allahut, drejtohet nga ai dhe i lutet atij, frikësohet prej tij dhe ka shpresë nga ai, i mbështetet dhe i bindet në mëkat ndaj Allahut dhe ndjek rrugë me të cilën nuk është i kënaqur Allahu, si: lutja, afrimi me therje kurbanit, zotimi tek varret dhe gjëra të tjera.

Allahu i Lartësuar thotë: *“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla*

[1] Buhariu 9/458-611

[2] Buhariu 6/21-24

[3] Muslimi 1/54-168

ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm.” Nisa: 48

Ibën Kethiri thotë: “Allahu i Lartësuar ka njoftuar se “nuk fal që atij t’i shoqërohet shok”, d.m.th. Allahu i Lartësuar nuk do ta falë atë rob që e takon Allahun si politeist.”

Allahu i Lartësuar thotë: “*Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ai me të vërtetë, ka humbur dhe është larguar shumë prej udhës së drejtë.*” Nisa: 116

Allahu i Lartësuar thotë: “*Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t’ia ndalojë xhennetin dhe strehim i tij do të jetë zjarri.*” Maide 72

Allahu i Lartësuar thotë: “*Kush i shoqëron Allahut diçka (në adhurim), i ngjan atij që bie nga qielli e që e rrëmben zogu ose i ngjan atij që stuhia e erës e ka hedhur në një vend të largët e të humbur.*” Haxh: 31

I Dërguari i Allahut thotë: “*E drejta e Allahut mbi robërit e Vet është që ata ta adhurojnë Allahun dhe mos t’i vënë për shok askënd, kurse e drejta e robërve ndaj Allahut është që Allahu të mos i dënojë ata që nuk i bënë shok Allahut në asgjë.*”^[4]

Ai që e shfaq haptazi këtë lloj shirku, del nga feja ashtu si mushrikët kurejshit dhe të tjerët si ata, kurse ai që e fsheh këtë lloj shirku është si munafikët-hipokritët, mashtruesit, të cilët shfaqin Islamit por fshehin kufrin.

Allahu i Lartësuar thotë: “*Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të xhennemit dhe ti kurrsesi nuk do*

t’u gjesht atyre ndihmës.” Nisa: 145

Allahu i Lartësuar thotë: “*Por ata që pendohen, përmirësohen, mbështeten fort tek Allahu dhe që besimin e tyre e kanë sinqerisht vetëm për Allahun, do të jenë me besimtarët e vërtetë.*” Nisa: 146

Robër të Allahut, ç’është shirku i vogël? Shirku i vogël është një lloj dyfytirësie që hyn në vepër; vepra është për qëllim të bëhet për Allahun e Lartësuar, pastaj ndryshon në dyfytirësi apo syfaqësi, e cila e prish atë vepër. Allahu i Lartësuar thotë: “*Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!*” Kehf: 110

I Dërguari i Allahut thotë: “*Ajo që më së shumti ua kam frikën juve është shirku i vogël.*” (Imam Albani në sahiha me nr rendor 951), është pyetur për të dhe tha: “dyfytirësia-syfaqësia” pastaj e shpjegoi me fjalët e tij i Dërguari i Allahut: “*ngritet njeriu për ta falur namazin, dhe e zbukuron namazin e tij me qëllim që njeriu tjetër ta shikon*”.^[5]

Nga shirku i vogël është zotimi (betimi) me dikë tjetër pos Allahut, si të thuash “betohem në prindër, në Qaben apo në amanetin” etj.

I Dërguari i Allahut thotë: “*Mos u betoni në baballarët tuaj e as për nënat tuaja e as për ata që ua vini si shokë Allahut.*”^[6]

I Dërguari i Allahut tha: “*Mos thoni pasha Qaben, por thoni pasha Zotin e Qabes.*”^[7]

[4] Buhariu 7/137, Muslimi 1/43, nga hadithi i Muadhrit, Allahu qoftë i kënaqur prej tij.

[5] Ibën Maxhe 2/1406-4204 hadithi është i mirë

[6] Sahih Ebu Davudi, Nesaiu 7/5

[7] Nesaiu, kapitulli i imanit 6/7, Ahmed 2/76-78 sahih.

I Dërguari i Allahut tha: “Mos u betoni - për askënd- vetëm për Allahun.”^[8]

I Dërguari i Allahut tha: “Ai që betohet për amanetin nuk është prej nesh.”^[9]

I Dërguari i Allahut tha: “Kush betohet me dikë tjetër jashtë Allahut ka bërë kufër apo shirk.”^[10]

Me një transmetim thuhet: “I ka bërë shok -shirk- Allahut”.

Nga shirku i vogël është të thuash: “Ç’deshi Allahu dhe ç’desha unë.” I Dërguari i Allahut i tha atij që e tha këtë fjalë: “A i bërë Allahut ortak-shok? Thuaj: “U bë vetëm ç’deshi Allahu i vetëm.”^[11]

Nga shirku i vogël është të thuash: “Sikur të mos ishte ndihma e Allahut dhe ti!” apo të thuash: “Nuk ka tjetër pos Allahut dhe teje!” apo “unë jam tek Allahu dhe tek ti!” apo diçka si kjo. I Dërguari i Allahut tha: “Mos thoni ç’deshi Allahu dhe filani, por thoni: “Ç’deshi Allahu, pastaj ç’deshi filani.”^[12]

Dijetarët kanë thënë: “Lejohet të thuhet “sikur të mos ishte -ndihma- Allahu pastaj filani”, dhe nuk lejohet të thuhet “sikur të mos ishte -ndihma- e Allahut dhe filanit”.

Shirku i madh nga ai i vogli dallohet sepse:

1 - Shirku i madh e nxjerr njeriun nga Islami, kurse shirku i vogël nuk e nxjerr.

2 - Shirku i madh e fut njeriun përgjithmonë në zjarr, kurse i vogli jo.

3 - Shirku i madh i shkatërron të gjitha veprat, kurse i vogli nuk i shkatërron të

gjitha veprat, pos atyre veprave që bëhen me dyfytyrësi apo syfaqësi.

4 - Shirku i madh e lejon gjakun dhe pasurinë, kurse i vogli nuk i lejon ato.

O Allah, kërkojmë nga Ti dije të dobi-shme, vepra të pranueshme, zemra të frikësuar, gjuhë që të përmendin vetëm Ty dhe trupa që durojnë ndaj sprovave!

Robër të Allahut!

U mbeta borxh këtë fjalë të Resulullahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, kur i tha Ibn Abasit: “O djalosh! Unë po të mësoj disa fjalë. Ruaje Allahun që Allahu të të ruajë ty, ruaje Allahun që ta gjesht Atë pranë. Kur të lutesh, lutju Allahut e kur të kërkosh ndihmë, kërkoi Atij. Dhe dije se sikur gjithë ummeti të bashkohet me qëllim që të të bëjnë dobi, nuk do të të bëjnë veçse aq sa Allahu ka caktuar për ty. Nëse të gjithë ata bashkohen për të të dëmtuar, nuk do të mundën veçse aq sa Allahu ka caktuar kundër teje. Lapsat janë ngritur dhe fletët janë tharë.”^[13]

Bazuar në:

1-Kurani i Madhërisëm, Prof. Hasan I. Nahi.

2-“Ilam el-sunneti el-menshureti”, Havidh el-Hakimi.

3-“Sherh thelatheti el-usul”, Muhammed Salih el-Uthejmin.

4-“Kitabu el-tevhid”, Salih Fevzan.

Përmbledhi dhe përshtati: Lirim Sadiku

[8] Buhariu, kaptina e tevhidit 8/14, Nesaiu 5/7, Ebu Davudi 3/222, nr. 3248.

[9] Imam Ahmedi në Musnedin e tij 5/352, Imam Albani në sahiha 1/86-87.

[10] Imam Ahmedi 5/352, Ebu Davud 3/223, nr. 3253, Albani në sahiha 1/86-87.

[11] Imam Ahmedi 1/214-224-347, Imam Albani në sahiha 139.

[12] Imam Ahmedi 5/394-298-384, Imam Albani në sahiha 139.

[13] Tirmidhiu, hadithi është hasen.

BESIMI NË MELAIKE

Nga dobitë e këtij hadithi, që është edhe qëllimi ynë i përmendjes së hadithit, është madhështia dhe fuqia e melekut të maleve, i cili kishte mundësi të bashkonte dy kodrat që rrethonin Mekën, sikur i Dërguari sal-Allahu alejhi ve sel-lem ta pranonte një gjë të tillë.

CILËSITË LËNDORE DHE ATO
ETIKE E MORALE TË
MELAIKEVE

Tema e parë:
Cilësitë lëndore të melaikeve

Në pjesën e dytë, tema nr. 2, përmendëm se melaiKET janë krijuar nga drita dhe se janë trupa në realitet. Allahu i ka veçuar ata nga njerëzit me veçori, ndërsa në këtë temë do të shtjellojmë, me emrin e Allahut, cilësitë më të rëndësishme trupore të melaikeve.

Çështja e parë

Madhështia trupore e melaikeve dhe fuqia e tyre

Argumentet e shumta nga Kur'ani dhe Sunneti tregojnë se Allahu i ka krijuar melaiKET në forma të mëdha dhe madhështore, të fuqishme, krijim që u përshatatet veprimeve dhe obligimeve që ua ngarkoi Allahu Fuqiptotë si në qiell ashtu edhe në tokë.

Allahu i Madhërishëm thotë: *"O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt e rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i*

urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar." Tahrîm: 6

Në komentën e këtij ajeti ka ardhur: "Të rreptë me zemra, ndërsa të ashpër me trupa, kanë fuqi aq të madhe, saqë zjarri që e shkrin hekurin dhe gurin nuk u bën dëm atyre."^[1]

Allahu thotë: "Ai (Ibrahimi) tha: "E ç'është puna juaj, o ju të dërguar?" Ata thanë: "Ne jemi të dërguar te një popull kriminel!" Që të hedhim mbi ta gurë nga balta (e pjekur)!(gurë) Të shënuar te Zoti yt, për ata që i kaluan kufijtë (në mëkatë)." Dharijat: 31-34

Gjithashtu Allahu thotë: "Kur erdhi urdhri ynë, Ne përmbysëm të gjitha ato (fshatrat e tyre) duke kthyer çdo gjë nga lart poshtë dhe mbi ta reshëm gurë të fortë pa ia ndarë." Hud: 82

Allahu thotë: "Atë ia mësoi Ai, fuqiforti, (Xhibrili). Që ka mendje precize dhe që u përqendrua në formën e vet (reale)." Nexhm: 5-6

Allahu thotë: "S'ka dyshim se ai (Kur'ani) është thënie e të Dërguarit fisnik (që e pranoi prej Zotit). Që është i fortë dhe që ka vend të lartë te Zoti i Arshit." Tekvir: 19-21

Ajetet që flasin për këtë çështje janë të shumta.

Argumente nga Sunneti

Hadithi i Aishes Allahu qoftë e kënaqur me të. Transmetohet se Aishja i ka thënë të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve

sel-lem: "O i Dërguar, a të ka ardhur ndonjë ditë që ishte më e vështirë sesa dita e Uhudit?" I tha: "Kam përjetuar nga populli yt shumë gjëra, por gjëja më e vështirë që e kam përjetuar prej tyre është dita e Akabes,^[2] kur u paraqita para ibën abdu Jalil ibën abdu Kelal dhe nuk m'u përgjigj në atë që desha. U largova nga aty i brengosur me kokë ulur dhe nuk jam kthjelluar deri kur arrita te Karn eth-thealib.^[3] E ngrita kokën lart, kur shoh një vranësi që më kishte mbuluar. Shikova, kur ja mbi të ishte Xhibrili, më thirri dhe më tha: "Me të vërtetë Allahu az-ze ve xhel-le i dëgjoji fjalët e popullit tënd dhe si t'u përgjigjën. (Allahu) Ka dërguar te ti melekun e maleve, që ta urdhërosh si të duash ndaj popullit tënd." I Dërguari tha: "Pastaj më thirri meleku i maleve, më përshëndeti me selam dhe më tha: "O Muhamed, me të vërtetë Allahu dëgjoji fjalët e popullit tënd, unë jam meleku i maleve. Zoti yt më ka dërguar te ti që të më urdhërosh çfarë të duash. Nëse do, t'i bashkoj dy kodrat (e ti zë ata në mes)." I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ia ktheu: "Jo, por shpresoj që Allahu të nxjerrë nga mesi i tyre dikë që e adhuron Allahun të vetëm dhe nuk i shoqëron Atij asgjë."^[4]

Ky hadith na tregon disa gjëra:

-Vështirësitë në të cilat ka hasur i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem duke thirrur popullin e tij në Islam.

-Butësinë dhe durimin e të Dërguarit

[1] Tefsiri i ibën Kethirit (4/391).

[2] Dita e Akabes është dita kur është ngritur i Dërguari në Mina për ta thirrur popullin në besim, por ata nuk iu përgjigjën dhe e munduan.

[3] Karn eth-thealib është mikati i Nexhdit, sot njihet me emrin Es-sejl el kebir.

[4] Transmeton Buhariu (3059), Muslimi (1795).

ndaj popullit të vet, ndjeshmërinë dhe mëshirën e tij për popullin e vet. Sikur ai të mos ishte durimtar me ta, ata do të shkatërroheshin. I Dërguari alejhi selam ishte dhuratë për ne nga ana e Allahut. Allahu thotë: *"Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët."* (Tevbe: 128)

Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të Dërguarin tonë dhe Zoti e shpërbleftë me shpërblimin më të mirë që ka shpërblyer ndonjëherë ndonjë të Dërguar.

Për thirrësin në rrugën e Allahut është obligim që ta pasojë rrugën e të Dërguarit alejhi selam, duke qenë njësoj si ai i mëshirshëm ndaj njerëzve, i kujdesshëm ndaj tyre dhe gjithashtu thirrjen ta fillojë ashtu siç e filloi i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, duke njësuar Allahun me adhurim.

Nga dobitë e këtij hadithi, që është edhe qëllimi ynë i përmendjes së hadithit, është madhështia dhe fuqia e melekut të maleve, i cili kishte mundësi të bashkonte dy kodrat që rrethonin Mekën, sikur i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ta pranonte një gjë të tillë. Ajo që tregon për madhësinë dhe fuqinë e trupave të melaikeve është edhe hadithi i Xhabirit Allahu qoftë i kënaqur me të, se i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Më është

lejuar të flas për një melek nga melaiket e Allahut, që është nga mbajtësit e Arshit. Me të vërtetë distanca mes laprës së veshit dhe kraharorit të tij është shtatëqind vite."^[5]

Është shumë normale që këto melaike të jenë kaq madhështorë sepse mbajnë krijesën më madhështore, Arshin. Do të flasim në detaje më vonë vetëm për mbajtësit e Arshit.

Përmendëm më herët se i Dërguari alejhi selam e ka parë Xhibrilin në formën që e ka krijuar Allahu. Nga madhështia ai kishte mbuluar horizontet.

Në hadithet e shpalljes transmetohet nga Aishja Allahu qoftë e kënaqur me të se El Harith ibën Hisham Allahu qoftë e kënaqur me të e kishte pyetur të Dërguarin: *"O i Dërguar i Allahut, më trego si të vjen shpallja."* I Dërguari i tha: *"Nganjëherë më vjen si zëri i ziles dhe ky lloj është më i vështiri për mua. Në fund më largohet dhe unë e kam mbajtur mend atë që më ka thënë. Nganjëherë meleku më shfaqet në formën e njeriut dhe më flet dhe e mbaj në mend se çfarë flet."* Aishja ka thënë: "E kam parë të Dërguarin duke i zbritur shpallja në ditë shumë të ftohtë. Kur i ndërpritej, e shihja ballin e tij të kullonte djersë."^[6]

Transmetohet nga Aishja Allahu qoftë e kënaqur me të se ka thënë: *"...derisa i erdhi e vërteta dhe ai ishte në shpellën Hira. I erdhi meleku dhe i tha: "Lexo!"* Ia ktheu: *"Nuk di të lexoj."* I Dërguari tha: *"Më mori dhe më shtrëngoi fort de-*

[5] Ebu Davudi (4727). Shiko "Silsilet el ehadith es-sahiha" të dijetar Albanit (1\151) dhe "El Adhametu" të Ebu esh-shejh (3\948).

[6] Buhariu (2) dhe Muslimi (2\333).

risa mundimi arriti kulminacionin."^[7]

Këto argumente tregojnë për fuqinë dhe madhësinë e melaikeve, prandaj duhet ta besojmë këtë dhe t'i cilësojmë melaiket me këto cilësi.

Çështja e dytë:

Krahët

Allahu i ka veçuar melaiket nga biri i Ademit duke u krijuar krahë me të cilët mund të fluturojnë mes qiellit dhe tokës me një shpejtësi të paparë, që e tejkalon çdo përmasë që ka njohur njeriu në këtë botë.

Allahu thotë: *"Falënderimi i qoftë Allahut, Krijuesit të Qiejve e Tokës, Sajuesit të engjëjve me nga dy palë, tre palë e katër palë krahë, ndërmjetësues (midis Tij dhe Pejgamberëve). Ai shton në krijim atë që do, vërtet Allahu ka fuqi për çdo send."*

Fatir: 1

Ibën Kethiri, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Do të thotë se disa prej tyre kanë nga dy palë krahë, disa kanë nga tri palë dhe ka prej tyre që kanë nga katër palë krahë, por ka edhe prej tyre që kanë edhe më shumë."^[8]

I Dërguari alejhi selam e ka parë Xhibrilin dhe ka thënë se kishte gjashtëqind palë krahë, siç tregon hadithi i Abdullah ibën Mes'udit, i cili thotë: "I Dërguari e ka parë Xhibrilin dhe ai kishte gjashtëqind palë krahë. Çdonjëri prej krahëve mbulonte horizontin. Krahët i shkëlqenin nga ngjyra të ndryshme dhe binin prej tyre margaritarë e diamante,

që veç Allahu e di më së miri".^[9]

Ky hadith tregon se krahët e melaikeve arrijnë deri në gjashtëqind palë e ndoshta ka edhe më shumë, Allahu e di më së miri. Kjo gjithashtu tregon se posedojnë krahë të mëdhenj dhe të bukur shumëngjyrësh, si ngjyrat e margaritarëve dhe diamanteve.

Këta krahë janë fisnikë dhe të mrekullueshëm. Allahu i nderon dijetarët me prezencën e melaikeve në bisedat e tyre dhe me mbulimin që ata u bëjnë atyre me krahë.

Transmetohet nga Ebu Hurejra se i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Allahu ka melaike që ecin nëpër rruqë duke vështruar ata që përmendin Allahun. Nëse gjejnë një popull që e përmendin Allahun, e thërrasin njëri-tjetrin "ejani tek ajo që po kërkoni". I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: "I mbulojnë ata me krahët e tyre lart deri në qiellin e kësaj bote."*^[10]

Melaiket kur shohin kërkuesit e dijes, ndalen së fluturuari dhe përuhin krahët e tyre, duke qenë të kënaqur me atë që vepron kërkuesi i dijes, siç tregon për këtë hadithi i Safvan ibën Assalit.^[11]

Këto citate treguan se këta krahë janë krahë prej vërteti, me të cilët melaiket fluturojnë dhe mbulojnë kërkuesit e diturisë, por ndoshta veprojnë me ata krahë edhe gjëra të tjera me të cilat ngarkohen, prandaj ne i besojmë këto citate, besojmë se melaiket kanë krahë që ua ka krijuar Allahu, duke u dalluar

[7] Buhariu (3) dhe Muslimi (160).

[8] Tefsiri i ibën Kethirit (3\546).

[9] Musned imam Ahmedi, vërtetuesi i "Musnedit". Ahmed Shakiri thotë se senedi i tij është i saktë (5\3748).

[10] Buhariu (6045).

[11] Ahmedi (4\239-240) dhe ibën Hibani (1319- el ihsan), senedi i tij është i saktë.

për nga numri i tyre. Ne besojmë se këta krahë janë të bukur, shumëngjyrësh dhe janë të fuqishëm. Allahu e di më së miri.

Çështja e tretë:

Mospasja nevojë për ngrënie dhe pirje

Folëm më herët për trupat madhështorë të melaikëve dhe fuqinë e tyre. Për njeriun është shumë normale që sa më shumë të shtohet masa dhe fuqia e trupit, shtohet edhe nevoja për ushqim, mirëpo ky argument i Allahut dhe krijimi madhështor i Tij këtë herë ndryshoi traditën e njohur tek njeriu.

Argumentet tregojnë se melaiket nuk kanë nevojë për ushqim, sepse trupat e tyre janë të krijuar në atë formë që nuk e pranojnë ushqimin. Nga këto argumente kemi fjalën e Allahut: *"Edhe Ibrahimit i patën ardhur të dërguarit (engjëjt) tanë me myzhde dhe i thanë: "Selam". Ai u përgjigj: "Gjithnjë paçi selam" dhe nuk vonoi t'ju sjellë një viç të pjekur (të fërguar në gurë). Kur pa se duart e tyre nuk shtrihen nga ai (viç), iu dukën të pazakonshme dhe ndjeu prej tyre njëfarë frike. Ata i thanë: "Mos u frikëso, ne jemi të dërguar te populli i Lutit."* Hud: 69-70

Ibën Kethiri thotë: "Melaiket nuk kanë oreks për ushqim dhe nuk e pëlqejnë dhe as nuk e hanë. Për këtë Ibrahim i alejhi selam pa se ata u tërhoqën kur u erdhni ai me ushqim duke u larguar në

tërësi nga ushqimi, atëherë edhe iu dukën të dyshimtë."^[12] Allahu thotë duke treguar gjendjen e Pejgamberëve: *"Ne edhe para teje nuk dërguam tjetër pos burra, të cilëve u dhamë shpallje, e nëse nuk e dini këtë, atëherë pyetni njerëzit e dijshtëm. Ne nuk i bëmë ata (Pejgamberët) trupa që nuk hanë ushqim e as nuk ishin të përjetshëm (të pavdekshëm)." En-bija: 7-8*

Ibën Xheriri, Allahu e mëshiroftë, kur komenton ajetin: *"O Muhamed, të dërguarit që i kemi dërguar para teje tek popujt e tyre nuk i kemi bërë "trupa që nuk hanë ushqim",* thotë: "Nuk i kemi bërë melaiket që të mos hanë ushqim, por i kemi bërë trupa si ti që hanin ushqimin."^[13]

Që melaiket nuk hanë ushqim është mendim unanim i dijetarëve.

Kurtubiu, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Dijetarët tanë, kur e kanë komentuar rastin e Ibrahimit me melaiket, kanë thënë: "Nuk kanë ngrënë melaiket sepse nuk hanë."^[14]

Ndërsa Sujutiu thotë: "Raziu në tefsirin e tij ka thënë: "Kanë rënë në ujdi se melaiket nuk hanë, nuk pinë dhe as nuk martohen, ndërsa xhinët hanë, pinë, martohen dhe lindin."^[15]

Dijetari i madh Muhamed Emin Shenkiti, Allahu e mëshiroftë, në tefsirin e tij thotë: "Nga tregimi i Ibrahimit me musafirët e tij nxirren shumë rregulla të pritjes së musafirët, ndër të cilat:

[12] Tefsir ibën Kethiri (2/451).

[13] Tefsir ibën Xherir (17/5).

[14] Tefsir Kurtubi (9/68).

[15] El Habaik (264).

a) Shpejtimi i shtrimit të ushqimit, sipas fjalës së Allahut: "... dhe nuk vonoi t'ju sjellë një viç të pjekur (të fërguar në gurë)...".

b) Që ushqimi të jetë nga më i miri që posedojmë, sepse Ibrahimisi kishte edhe lopë, por viçi i majmë dhe i rritur është më i mirë.

c) Afrimi i ushqimit te musafiri.

d) Të folurit butë me ta, siç u tha Ibrahimisi: "*A nuk po hani...?*"^[16]

Çështja e katërt:

Melaiket mbeten në esencën e krijimtarisë së tyre, nuk lindin e as nuk martohen

Allahu i ka veçuar melaiket që të jenë krijesa që krijohen secila më vete dhe nuk cilësohen me cilësi mashkullore e as femërore. Ata mbeten në esencën e krijimit të tyre, siç i ka krijuar Allahu. Këtë e dëshmojnë argumentet nga Kur'ani dhe Sunneti.

Allahu thotë: "*E ti (Muhamed) pyeti ata (idhujtarët): "A të Zotit tënd janë vajzat, kurse të tyre djemtë?" Apo, Ne i krijuam engjëjt femra, e ata ishin dëshmitarë (kur Ne i krijuam engjëjt femra)! Vini re se si ata nga trillimet e tyre thonë: "Allahu ka lindur!" S'ka dyshim se ata janë gënjeshtarë (kur thonë se engjëjt janë bijat e Zotit). A thua vajzat Ai i ka bërë më të zgjedhura se djemtë? Po ç'keni ju kështu, si po gjykoni ashtu?"* Essaffat: 149-154 Ibën Kethiri, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Allahu tregoi për njerëzit që kanë folur ndaj melaikëve tri fjalë që

janë kulmi i mosbesimit dhe gënjeshtres.

E para: I kanë konsideruar vajza të Allahut, pra i kanë atribuuar Allahut fëmijë, Allahu qoftë i lartë.

E dyta: Këta fëmijë kanë thënë se janë vajza.

E treta: I adhuruan përpos Allahut subhanehu ve tealë.

Çdonjëra nga këto fjalë është e mjaftueshme që thënësi i tyre të qëndrojë në zjarrin e xhennemit përgjithmonë.^[17]

Allahu thotë: "*Megjithëse (pranuan se Zoti është i vetmi krijues), ata i përshkruan Atij pjesë (fëmijë) nga robërit e Tij. Njeriu i tillë njëmend është mohues i hapët. A mos Ai nga ato që krijoi, për vete përcaktoi vajza, kurse juve u dalloi me djem? E kur ndonjëri prej jush lajmërohet me (lindje të vajzës) atë që ia pat përshkruar Zotit shembull, fytyra e tij nxihet dhe i zihet fryma. A, atë që rritet me stoli e në dialog është i paqartë (ia përshkruajnë Zotit)? Edhe engjëjt, që janë adhurues të Zotit, i quajnë femra? A prezantuan ata në krijimin e tyre (melekëve)? Dëshmia e tyre do të regjistrohet dhe ata do të merren në pyetje. Ata pastaj thanë: "Sikur të kishte dashur Allahu, ne nuk do t'i adhuronim ata (as idhujt e as melaiket). Ata nuk kanë për këtë (që thonë) ndonjë fakt, ata vetëm gënjejnë."* Zuhruf: 15-20

Fjala e Allahut: "*A prezantuan ata në krijimin e tyre (melekëve)?"*

[16] Edvaul bejan (3/27).

[17] Tefsir ibën Kethir (4/22).

Ibën Kethiri, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Këta lloj njerëzish bashkuan shumë lloje gabimesh:

E para: I atribuan Allahut fëmijë, Allahu qoftë i lartë dhe i pastër nga ajo që thonë.

E dyta: Thënia e tyre se Allahu i ka veçuar vajzat nga djemtë dhe këtu melaiket, të cilët janë robër të Allahut, i kanë bërë femra.

E treta: Adhurimi i tyre ndaj melaikëve pa asnjë argument dhe pa leje nga Allahu, por vetëm me epsh dhe hamendje dhe pasim verbal të të parëve, udhëheqësve, gjyshërve të tyre dhe zhytje në injorancë të thellë.

E katërta: Argumentimi i tyre me kader në këtë rast, duke treguar një injorancë të thellë. Allahu ua mohoi shumë fuqishëm një arsytim të tillë, sepse Allahu qëkurse ka dërguar Pejgamberët dhe u ka zbritur librat, ka urdhëruar që të adhurohet i vetëm duke mos i bërë shok askënd në adhurimin ndaj Tij.”^[18] Ajo që na interesoi ishte se Allahu refuzoi atë që melaiket janë vajzat e Allahut dhe se janë femra. Ai vërtetoi për Vetveten se nuk ka lindur kënd dhe nuk është i lindur dhe se Atij askush nuk i është i barabartë. I madhëruar qoftë Allahu! Në të njëjtën kohë i ka cilësuar melaiket se janë robër të Allahut, d.m.th se i ka krijuar që ta adhurojnë Atë. U mjafton për nder kjo melaikëve dhe fakti se ata janë krijesa

të veçanta, as meshkuj e as femra.

Çështja e pestë:

Argumentet tregojnë se melaiket flasin dhe fjala e tyre dëgjohet. Cilësia e të folurit tek melaiket është e pranishme edhe kur paraqiten në formën e njeriut

Allahu u ka folur atyre dhe ata i kanë folur Allahut. Allahu thotë: *“(Përkujto Muhamed) Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!” Ata thanë: “A do të vësh në të atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjajat, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini!”* Bekare: 30

Melaiket i kanë folur Ademit alejhi selam pas krijimi të tij.

Transmetohet nga Ebu Hurejra Allahu qoftë e kënaqur me të, nga i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem se ka thënë: *“Allahu e ka krijuar Ademin në formën e tij dhe gjatësia e tij ishte gjashtëdhjetë krahë, e pastaj i tha: “Shko dhe përshëndeti me selam atë grup melaikësh dhe dëgjo se me çka të përshëndesin ato ty, me përshëndetjen tënde dhe të pasardhësve tu. (Ademi iu tha) Es-selamu alejkum, ndërsa melaiket i thanë: Es-selamu alejke ve rahmetullah, shtuan ve rahmetullah. Çdokush që hyn në xhennet është në formën e Ademit dhe ka vazhduar të pakësohet deri sot.”*^[19]

Melaiket i flasin njëri-tjetrit, siç thotë

[18] Po aty (4/125).

[19] Buhariu (3148) dhe Muslimi (2841).

Allahu i Madhërishëm:

"...e kur hiqet frika nga zemrat e tyre (të ndërmjetësuesve), ata thonë: "Çka tha Zoti juaj!" (rreth shefatit). Ata (engjëjt e lartë) thonë: "Të vërtetën!" (u dha leje). Ai është më i larti, më i madhi." Sebe'e: 23

Ndodh që shejtanët të dëgjojnë fjalët e melaikëve, siç tregon hadithi i Aishes Allahu qoftë e kënaqur me të, se ajo e ka dëgjuar të Dërguarin sal-Allahu alejhi ve sel-lem duke thënë: *"Melaiket zbresin në Anan e ajo është re (vranësirë) dhe përmendin një çështje që është vendosur në qiell. Shejtanët e vjedhin këtë të dhënë. Atëherë drejtohen te fallxhorët dhe ia shtojnë edhe njëqind gënjeshtër nga vetja e tyre."*^[20]

Melaiket i flasin njeriut sipas gjuhës së tyre dhe nuk kanë nevojë për ndërmjetësues, siç ndodhi me pejgamberët nga Beni Israilët dhe me të tjerë dhe siç ka ndodhur me të Dërguarin tonë sal-Allahu alejhi ve sel-lem.

Ata i flasin njerëzve edhe në varreza, siç është e njohur në rastin e sprovës së varrit.

Ata u flasin njerëzve në Ditën e Gjykitimit duke i përgëzuar ose qortuar.

U flasin banorëve të xhennetit dhe i përshëndesin me selam.

U flasin banorëve të xhehennemit dhe i përgëzojnë me dënim.

Argumentet për këto që thamë janë të shumta dhe të njohura.

[20] Buhariu (3038).

[21] "El Kavul mufid" (1/411).

[22] Po aty (1/395).

Rezymeja është se nga cilësitë trupore të melaikëve janë se ata flasin dhe kjo është cilësi e përkryeshmërisë. Është obligative të besohet kjo dhe të cilësohen melaiket me këtë cilësi.

Dijetari Muhamed ibën Salih Uthejmin, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Ky ajet kur'anor tregon se melaiket flasin, kuptojnë dhe logjikojnë, sepse ata pyesin: "Ç'tha Zoti juaj?!" (rreth shefatit)" dhe përgjigjen. "Ata (engjëjt e lartë) thonë: "Të vërtetën!"

E themi këtë duke iu kundërvënë atyre që thonë se melaiket nuk cilësohen me këtë cilësi, d.m.th. se ne e kemi pranuar sheriatin (fenë) nga dikush që nuk ka mendje dhe kjo pa dyshim është nënçmim për sheriatin."^[21]

Ajeti tregon gjithashtu se melaiket kanë zemra të cilat i kaplon frika dhe tmerri nga Allahu.^[22]

Shkëputur nga libri

"Bindjet e fraksioneve muslimane dhe feve të tjera rreth melaikëve të ndershëm"

Autor: Dr. Muhamed ibën Abdulvehab El Akil Mësimdhënës në Universitetin Islamik të Medinës

Përshtati:

Fidan Xhelili



Dashuria për ALLAHUN

Ibën Kajimi, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Kur u shtuan pretenduesit ndaj dashurisë Allahu zbriti ajetin." Thuaj: "Nëse e doni Allahun, atëherë më ndiqni-pasoni mua." Alu Imran:31

Prej cilësive të Allahut është "Dashuria". Allahu i do robërit e Tij besimtarë me një dashuri që i takon Atij. Robërit e Tij e duan Atë më shumë sesa pasurinë, fëmijët dhe veten e tyre. Thotë i Lartësuari: *"O ju që besuat! Kush largohet prej jush nga feja e vet (i bën dëm vetes), s'ka dyshim se Allahu do të sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë."* Maide: 54

Dashuria është reciproke në mes Allahut dhe robërve të Tij. Allahu thotë: *"E nga njerëzit ka të tillë që në vend të Allahut besojnë idhujt, që i duan (i madhërojnë) ata,*

sikur (besimtarët e vërtetë e duan) Allahun, po dashuria e atyre që besuan Allahun është shumë më e fortë." Bekare: 165

Dashuria ka një pozitë të madhe, garojnë në të garuesit, punojnë punuesit, shpenzojnë shpenzuesit. Të parët u përkushtuan në arritjen e saj, me të forcohen zemrat, ushqehen shpirtrat, kënaqet syri. Ajo është jetë nëse e humb, do t'u ngjash të vdekurve. Dashuria është dritë- kush e humb, mbetet në errësirë. Ajo është ilaç- nëse nuk e përdor, të gjitha sëmundjet do të bien në zemrën tënde. Dashuria është ushqim i këndshëm kush nuk e shijon, do të jetojë

një jetë me brenga dhe dhembje.

Vendimi mbi dashurinë për Allahun

Dashuria për Allahun është obligim ligjor për çdo adhurues. Këtë e kundërshton vetëm ai që e ka zemrën e errët apo të verbër. Allahu thotë: *"Thuaj: (o i Dërguar): "Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që fituat, tregtia që frikësoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se Allahu, se i Dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur."* Tevbe: 24

Allahu u premtoi për preferencë për dashuri të tjera ndaj dashurisë së Tij dhe dashurisë së Pejgamberit të Tij, premtimi nuk ndodh vetëm se në farze të domosdoshme apo obligime.

Transmetohet nga Enes ibën Maliku, Allahu qoftë i kënaqur me të, se Pejgamberi alejhi selam ka thënë: *"Nuk ka besuar askush prej jush derisa të jem më i dashur tek ai sesa fëmija, prindi dhe tërë njerëzit."* Mutefekun alejhi

Gjithashtu nga Umeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, i cili ka thënë: *"O i Dërguar i Allahut! Pasha Allahun, ti je më i dashur te unë se çdo gjë, përveç vetes sime."* Pejgamberi i tha: *"Jo, o Umer, përderisa të mos jem më i dashur sesa vetja jote."* Umeri tha: *"Pasha Allahun, ti tani je më i dashur sesa vetja ime."* Ia ktheu Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *"Tani, o Umer."* Mutefekun alejhi

El-hafidh ibën Rexhebi, Allahu e mëshiroftë, thotë: *"Është e ditur se dashuria për Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem*

është vazhdueshmëri e dashurisë për Allahun. Ne e duam Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në pajtim me atë që do Allahu për të dhe me dashurinë që na ka urdhëruar ndaj tij, duke e respektuar dhe pasuar atë.

Përderisa besimi (imani) nuk plotësohet vetëm se me vendosjen e dashurisë për Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem para asaj për veten, fëmijët, prindërit dhe të gjithë krijesat, çfarë mendon për dashurinë për Allahun?"

Dashuria për Allahun është prej shenjave të besimit

Pejgamberi alejhi selam e ka bërë përparësinë e dashurisë së Allahut dhe të të Dërguarit të Tij ndaj dashurisë së të tjerëve prej cilësive të imanit dhe prej shenjave se në zemrën e njeriut gjendet ëmbëlsia e besimit. Transmetohet nga Enesi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush ka tri cilësi, ka gjetur ëmbëlsinë e besimit: të jenë Allahu dhe i Dërguari i Tij më të dashur se gjithë të tjerët, ta dojë njeriun vetëm për hir të Allahut, ta urrejë kthimin në mosbesim pasi Allahu e shpëtoi prej tij, siç urren të hidhet në zjarr."* Mutefekun alejhi

Në këtë kuptim, Allahu thotë: *"O ju që besuat, kur t'ju vijë besimtaret e shpërngulura (prej Mekës), provoni besnikërinë e tyre, ndonëse Allahu di më së miri për besimin e tyre; nëse vërtetoni se ato janë besimtare, atëherë mos i ktheni ato te jobesimtarët."* Mumtehine: 10

Allahu e urdhëroi këtë provim që të dihet besimi i tyre. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem betohej se ato ishin shpërngulur vetëm për dashurinë që kanë pasur për All-

ahun dhe të Dërguarin e Tij dhe se nuk ishin shpërngulur për ndonjë çështje tjetër. Kjo tregon për besimin e tyre.

Një pushim dhe disa pyetje

I dashur vëlla!

Nëse dashuria për Allahun e Madhëruar është obligim i domosdoshëm dhe se kjo dashuri është prej virtyteve të besimit dhe shenjave të tij, ku jemi ne në raport me këtë adhurim?

A jemi ne prej atyre që e duan Allahun?

A jemi prej atyre që i do Allahu?

Ibën Kajimi, Allahu e mëshiroftë, thotë:

“Kur u shtuan pretenduesit ndaj dashurisë Allahu zbriti ajetin.” Thuaj: *“Nëse e doni Allahun, atëherë më ndiqni-pasoni mua.”* Alu Imran:31

Vazhdon Ibën Kajimi e thotë: “Ky ajet quhet ajeti i dashurisë”.

Sulejman el-Daranij, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Kur zemrat pretenduan për dashuri për Allahun, Allahu zbriti ajetin e provimit. Disa selefë kanë thënë: “Një popull pretendoi dashurinë për Allahun, atëherë Allahu zbriti ajetin e provimit, ku thotë: *“Thuaj: “Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t’ju dojë.”* Alu Imran: 31

Fjala e Allahut: *“Atëherë ejani pas meje që Allahu t’ju dojë”* është shenjë që argumenton për dashurinë, frytet dhe dobitë e saj. Argumenti dhe shenja e saj është pasimi i

Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Dobia dhe fryti i saj është dashuria për të Dërguarin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Nëse ai nuk pasohet, nuk kemi arritur dashurinë për të dhe dashuria e tij për ne është e ndaluar.

Ku jemi ne në pasimin e Sunnetit të Pejgamberit?

Ku jemi ne në pasimin e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në adhurimet, sjelljet dhe moralin e tij?

Ku jemi ne në pasimin e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në namaz, zekat, agjërim, haxh?

Ku jemi ne në pasimin e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në përmendjen e Allahut, lutje, lexim Kur'ani, kërkim ndihme nga Allahu Fuqplotë, në mbështetjen tek Ai?

Ku jemi ne në pasimin e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në shoqërimin e vëllezëreve, bamirësinë me fqinjët, respektimin e prindërve, respektimin e musafirëve, lidhjen farefisnore, vizitat e të sëmurëve, bamirësinë ndaj të dobët, kryerjen e nevojave të nevojtarëve, jetimëve dhe të varfëve?

Ku jemi ne në pasimin e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në modesti, edukatë, mëshirë, butësi, respektim, buzëqeshje të fytyrës, falje dhe moral të mirë?

Ku jemi në pasimin e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në forcë, trimëri, politikë, gjykim në paqe dhe luftë, në ar-



mëpushim, në përgatitjen e ushtrisë për konfrontim me armiqët e Allahut në çdo vend?

Vëlla i dashur!

Nëse në zemër mbillet pema e dashurisë dhe ujitet me ujë të sinqertë dhe pasim të Pejgamberit alejhi selam, ajo do të japë fryte të ndryshme dhe prej saj do të ushqehemi në çdo kohë, me lejen e Allahut. Bazën e saj është e fortë në vendimin e zemrës dhe degët i ka të lidhura te Sidretu el Munteha. Ajo vazhdon të ngrihet tek i dashuri i tij dhe nuk e pengon asgjë. Allahu thotë: *"Tek Ai ngrihet fjala e mirë (besimi) dhe veprimi i mirë, e Ai i pranon."* Fatir: 10

Virtytet e të dashurve

Allahu ka përmendur disa virtyte të të dashurve duke thënë: *"O ju që besuat! Kush largohet prej jush nga feja e vet (i bën dëm vetes), s'ka dyshim se Allahu do të sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin), (një popull) që është modest dhe i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve, që lufton në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo (cilësi e atij populli) është dhuratë e Allahut që ai i jep atij që do. Allahu është dhurues i madh, i dijshtëm."* Maide: 54

Allahu i Madhëruar ka përmendur katër shenja.

E para: Ata janë: *"Modestë dhe të butë ndaj besimtarëve"*, d.m.th. të mëshirshëm, të butë ndaj tyre (besimtarëve). Thotë: Atau Allahu e mëshiroftë: Sillet me besimtarët mirë sikurse prindi me fëmijën e tij, sillen me jobesimtarët sikur luani në gjahun e tij.

Kështu ka qenë Pejgamberi, i butë, falës, i mëshirshëm ndaj besimtarëve, siç thotë Allahu: *"Juve ju erdhi i Dërguari nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët."*

Tevbe: 128

Gjithashtu Allahu thotë: *"Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikurse të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje."* Alu Imran: 159

E dyta: Ata janë: *"Të ashpër dhe të fortë ndaj mohuesve."* Ibën Kethiri, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Këto janë cilësitë e besimtarit të plotë, të jetë modest me vëllanë e tij, i ashpër me armikun e tij, siç ka thënë Allahu: *"Muhamedi alejhi selam është i Dërguari i Allahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete."* Fet'h: 29

Prej cilësive të Pejgamberit sal-Allahu alejhi ve sel-lem është edhe buzëqeshja, por ishte njëkohësisht luftëtar i madh, i qeshur me shokët e tij, por luftëtar i ashpër kundër armikut.

E treta: Xhiahadi (lufta) në rrugën e Allahut me shpirt, dorë, gjuhë, pasuri. Ky është vërtetim i dashurisë.

E katërta: Ata nuk i frikësohen kërcënimit të asnjë kërcënuesi dhe kjo është shenjë e dashurisë së shëndoshë. Kur dikush merr kërcënim nga ai që do, kjo nuk konsiderohet dashuri e vërtetë.

*Përgatiti: Darul Vatan
Përshtati: Fehmi Dalipi*

DISA GABIME NË EDUKIMIN E FËMIJËVE (I)



Prindërit nuk u flasin fëmijëve në mënyrën më të drejtë. Fëmija 1 deri 3 vjeç: atëherë kur përpiqet të mundohet të flasë, shumë prindër i flasin fëmijës me “fjalë bebesh” duke u mundur të kontaktojnë me fëmijën. Edhe pse ky është një gabim, disa prindër nuk e shohin si gabim. Mirëpo pasojat nuk janë edhe aq të mëdha, mirëpo kjo vlen më shumë për mentalitetin dhe kapacitetin e fëmijës.

NË EMËR TË ALLAHUT,
MËSHIRUESIT, MËSHIRËBËRËSIT!

Kur ti linde, prindërit e tu pa dyshim që janë gëzuar pa masë dhe zemra e tyre është mbushur plot gëzim para se në fytyrën e tyre të vizatohet buzëqeshja. Ti ishe gëzimi dhe ardhmëria e familjes. Gjithashtu ishe ai/ajo që prindërit e ruajnë si dy sytë e tyre, duke u munduar t’i plotësojnë çdo dëshirë dhe ta bëjnë të lumtur në çdo fazë të jetës.

Ti ishe ai/ajo që nga asgjë u bërë një pikë ujë. Allahu thotë: *“Për Allahun, Ne e krijuam njeriun prej një ajke (lëngu), e një balte. Pastaj atë (ajkë - baltë) e bëmë (e shndërruam) pikë uji (farë) në një vend të sigurt.”* Muminun: 12 Dhe nga ajo një pikë gjaku. Allahu thotë: *“Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjak...”* Kështu u rrite dhe u bërë edhe mish edhe eshtra duke të plotësuar Allahu teala pastaj me një shpirt. Allahu tha: *“...e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra, edhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është All-*

llahu, më i miri Krijues!” Muminin: 14

U bërë njeri dhe dole në këtë botë me plot mund nga ana e nënës tënde të dashur. Nëna të mbajti 9 muaj, me shumë dhimbje dhe mundime të papërshkrueshme. Por ajo vazhdimisht gëzohej për ty.

Para se të lindje, prindërit u menduan shumë se si ta edukojnë fëmijën që do t’u vijë në familje. Ata i menduan të gjitha: shkollimin, veshmbathjen, ushqimin, martesën etj. Mirëpo kur linde ti dhe fillove të zhvillohesh si i madh, edukimi ishte më ndryshe se ç’menduan, sepse nuk ishte aspak i lehtë. Vërtet edukimi i fëmijës ishte i vështirë dhe është sot për shumë prindër. Sa është fëmija i vogël, mendojmë që është më lehtë sesa kur të rritet, mirëpo nuk po marrim në konsideratë disa gabime që bëjmë në fazën kur fëmija është i vogël.

Fëmija ka nevojë për edukim tërë jetën, jo vetëm atëherë kur e sheh që është gabim, por gjithmonë dhe vazhdimisht.

Fëmija nuk ka nevojë vetëm për ushqim dhe veshmbathje, mirëpo edhe për dashuri, mbi-këqyrje të drejtë, ndihmë në zhvillimin e tij

dhe vazhdimisht ka nevojë për mësim dhe fjalë këshilluese. Allahu thotë: *“Dhe dijeni se pasuria e juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm një provë dhe se tek Allahu është shpërblimi i madh.”* Enfal: 28

Vërtet bashkëpunimi me fëmijët është i rëndësishëm, një gjë që shumë nënave dhe baballarëve u duket e vështirë. Fëmija e kupton veten e tij sipas mësimave dhe edukatës që merr nga prindërit. Nëse ti, si prind e bën të ndihet se ai është “fëmijë i mirë” dhe i dhuron dashurinë tënde, edhe ai do të mendojë për veten e tij se është i mirë e i nderuar dhe se ka vlera. Por kur nuk ke durim në bashkëpunimin me të, atëherë e bën të ndihet se ai është “fëmijë jo i mirë”, duke e qortuar dhe kritikuar. Atëherë pa dyshim që fëmija do të ketë mendim negativ për vetveten. Kështu që çështja përfundon te prindi dhe jo te fëmija, sepse fëmija si qenie është e pafajshme. Prindi është edukatori i fëmijës dhe është një pjesë e personalitetit të fëmijës, që e përcjell tërë jetën. Në vazhdim do të përmendim disa gabime në edukimin e fëmijëve, që prindërit të jenë më të vëmendshëm kur hasin në situata të caktuara. Shpresojmë, me emrin e Allahut, që do të jenë të dobishme.

1. Biseda me fëmijën

1 Prindërit nuk u flasin fëmijëve në mënyrën më të drejtë. Fëmija 1 deri 3 vjeç: atëherë kur përpiqet të mundohet të flasë, shumë prindër i flasin fëmijës me “fjalë bebesh” duke u mundur të kontaktojnë me fëmijën. Edhe pse ky është një gabim, disa prindër nuk e shohin si gabim. Mirëpo pasojat nuk janë edhe aq të mëdha, mirëpo kjo vlen më shumë për mentalitetin dhe kapacitetin e fëmijës.

Pasojat: Ato janë që fëmijës do t'i nevojitet më shumë kohë të mësojë gjuhën mirë dhe të flasë pastër, ngase prindërit vazhdimisht i flasin me gjuhë jo të rregullt. Fëmija do të ketë gjithashtu edhe më shumë vështirësi të mësojë shpejt dhe do të jetë i ngadalshëm në mësimin e

fjalëve drejt.

Përmirësimi: Vazhdimisht duhet t'i flasin fëmijës me zë të butë dhe jo të lartë, mirëpo fjalët duhen thënë ashtu siç janë dhe jo t'i shtrembërojmë. Gjithashtu duhet të përdorim fjalë të lehta, në mënyrë që fëmija të kuptojë më lehtë. Kështu do ia lehtësojmë rrugën fëmijës për të mësuar gjuhën e drejtë sepse nëse fëmija i dëgjon fjalët ashtu siç janë dhe ashtu siç flasin me të rriturit, ai/ajo do t'i mësojë fjalët para kohe dhe do bëhet më i ditur sesa fëmija që është mësuar nga prindërit e vet deri vonë me fjalë “fëmijësh”.

2 Disa prindër shumë herë harrojnë të ulen me fëmijën e vet dhe të bisedojnë me të. Ndodh që i flasin nga larg për ndonjë gjë, apo me një distancë dhe duke mos e afruar afër vetes ose i flasin nga larg me një zë të lartë, që ndikon shumë keq tek fëmija. Kështu mbeten duke bërtitur me zë të lartë mes njëri-tjetrit ose i flasin nga larg, mirëpo fëmija nuk i merr seriozisht ato fjalë. Gjithashtu, ndodh që prindi të flasë nga larg, mirëpo nuk e shikon fëmijën, shikon televizion, në internet, gazetë apo merret me ndonjë gjë tjetër. Këtu fjalët nuk do merren parasysh dhe do humbin si në ajër.

Pasojat: Nëse flet me fëmijën nga larg dhe me zë të lartë, kjo do shkaktojë që fëmija të mësohet të bërtasë; gjithashtu do sjellë një edukatë tepër të pahijshme dhe arrogante në familje me këto zëra. Nëse prindi flet nga larg me fëmijën, fëmija e ka më të lehtë të mos i marrë fjalët e prindit seriozisht apo si të mëdha. Fëmija do mbetet neglizhues ndaj urdhrave të prindit.

Përmirësimi: Fëmija e ka të lehtë t'i marrë fjalët jo seriozisht dhe të mendojë që kjo nuk është me rëndësi. Mirëpo nuk vepron ashtu nëse prindi drejtohet me fytyrë e trup nga fëmija dhe ulet me të që të bisedojë. Që në fillim pyete fëmijën a bën të bisedojmë. Këtë nuk e bën për të marrë leje, mirëpo që fëmija të ndiejë kënaqësi që prindi po e pyet për një gjë të tillë. Pastaj ulu me fëmijën në një ambient

të qetë dhe tregoji për çfarë dëshiron të bisedosh. Tregoji fëmijës qartë se çfarë dëshiron si prind, pastaj jepi më vonë edhe fëmijës hapësirë për t'u shprehur.

3 Pakujdesia në dëgjim në raport me fëmijën është një faktor që çon te humbja e respektit mes fëmijës dhe prindit- kur prindi nuk i dëgjon fjalët e fëmijës, i nënvlerëson dhe nuk e lejon të shprehet apo të tregojë idetë dhe bindjet e veta ose kur prindi e dëgjon fëmijën, mirëpo e pengon në të shprehur apo e ndërpret çdoherë dhe pastaj ai nuk mund të shprehet mirë.

Pasojat: Pakujdesja në dëgjimin e fëmijës shkakton që fëmija të humbë vetëbesimin dhe të mos ketë komunikim të mirë me prindërit. Kjo shkakton gjithashtu humbje të dashurisë dhe harmonisë në familje. Fëmija do ketë frikë të tregojë mendimet dhe besimet e veta edhe më vonë në jetën e vet. Gjithashtu, kur prindi nuk e lejon fëmijën të shprehet lirshëm, do ndodhë e kundërta: fëmija nuk do ta respektojë prindin kur të flasë.

Përmirësimi: Prindi duhet ta lërë fëmijën të shprehet për atë që ka nevojë. Duhet ta lërë fëmijën të flasë, të japë ide, të japë ndoshta edhe këshilla dhe të thotë mendimin e vet në përgjithësi sepse fëmija ka nevojë për dëgjimin dhe vëmendjen e prindërve ndaj tij. Gjithashtu, prindi duhet t'i vlerësojë mendimet e fëmijës, të japë komplimente që fëmija të vazhdojë të përmirësohet. Për shembull, nëse fëmija vjen nga shkolla dhe tregon se çfarë i ka ndodhur, ti si prind dëgjoje fëmijën deri në fund dhe mos e ndërprit. Nëse fëmija të tregon për notat e tij, atëherë dëgjoje me vëmendje dhe jepi kurajë që të arrijë nota edhe më të mira. Thuaji gjithashtu që të jetë mirënjohës dhe ta falënderojë Allahun e Madhërisëm për suksesin në mësim. Kështu do jesh mbështetës i fëmijës dhe fëmija do jetë i kënaqur edhe me veten edhe me prindin.

4 Shumë prindër, për mos të thënë të gjithë, u flasin fëmijëve të vegjël nga lart. Me këtë dua të them që prindi qëndron në këmbë kur bisedon me fëmijën dhe e shikon nga lart poshtë. Kurse fëmija qëndron poshtë dhe shikon nga poshtë lart. Ndoshta je duke menduar se ku është gabimi. Është gabim pikërisht se komunikimi bëhet tepër i dobët dhe fëmija ndihet shumë i pasigurt. Gjithashtu fëmija nuk do ta marrë prindin me seriozitet nëse nuk ulet në gjunjë për t'i folur apo për t'i shpjeguar ndonjë gjë.

Pasojat: Fëmija bëhet i padurueshëm duke kërkuar nga prindërit vëmendje. Fëmija që nga moshë shumë e re dhe afër kohës kur arrin moshën e pjekurisë dëshiron gjithmonë të ketë vëmendjen e prindërve. Sidomos kur fëmija është nga 1ë 3 vjeç. Fëmija mundet shumë lehtë të mos e marrë fjalën tënde sepse ti nuk komunikon me të direkt. Edhe dashuria zbehet kur prindi qëndron lart dhe nuk mundohet t'i afrohet fëmijës sa më shumë duke komunikuar qartë me të.

Përmirësimi: Duhet të ulemi më poshtë që të jemi në të njëjtin nivel si fëmija, ta shikojmë në sy dhe të komunikojmë më mirë. Këtu fëmija e kupton situatën më mirë, i dëgjon fjalët më qartë dhe do ta marrë prindin më me seriozitet sesa kur qëndron lart. Për shembull, kur fëmija pranë teje duke shëtitur fillon të gjuajë gurë dhe të mbledhë mbeturina dhe ti si prind i flet nga larg, ai fëmijë do vazhdojë atë që po bën. Mirëpo nëse afroresh afër fëmijës dhe ulesh në një nivel me të dhe i thua: "Kjo gjë nuk është e mirë dhe s'duhet vepruar kështu", pa dyshim që fëmija do dëgjojë më shumë.

Vijon...

Laura Ferati, Norvegji

SHPJEGIMI I HADITHIT: “PRETENDUESI I DIÇKAJE DUHET TË SJELLË FAKT VËRTETUES, NDËRSA REFUZUESI (PALA E AKUZUAR) MJAFTON TË BETOHET”

Nëse dy persona bien dakord për një lloj akti dhe e përfundojnë, më pas njëri pretendon se akti nuk është korrekt për shkak të mungesës së një kushti, një elementi bazik apo një pengese, ndërkohë që tjetri e refuzon këtë pretendim, do të merret në konsideratë thënia e atij që mbron vlefshmërinë e aktit.

NGA SHEJHU EL ALAMEH ABDUR-
RAHMAN BIN NASIR ES-SA'DIJ


“Pretenduesi i diçkaje duhet të sjellë fakt vërtetues, ndërsa refuzuesi (pala e akuzuar) mjafton të betohet.”

Sa fjalë madhështore dhe gjithëpërfshirëse e ngjarjeve dhe ndodhive të ndryshme që hasen mes njerëzve, qoftë në të drejtat individuale apo në lidhje me pasuritë dhe borxhet, sa herë që ndodhin konflikte, mosmarrëveshje apo paqartësi!

Ky është parimi që u jep përgjigje të gjithë këtyre problemeve, duke gjykuar se pretenduesi (akuzuesi) duhet të sjellë fakt vërtetues për akuzën e tij, ndërsa pala tjetër (i akuzuari) mjafton që të betohet kundër asaj

akuze, përderisa akuzuesi nuk sjell dot fakte dhe argumente vërtetuese.

Ky parim përfshin çështje të ndryshme, por prej tyre do të përmendim shembujt e mëposhtëm:



1 Nëse dikush pretendon një të drejtë ndaj dikujt, qoftë në lidhje me gjakun, pasurinë apo diçka tjetër, duke mos sjellë fakte, dhe i akuzuari e mohon akuzën e ngritur ndaj tij.

2 Nëse është i pohuar (i vërtetuar) një obligim i një personi ndaj një tjetri dhe më pas ai (i pari) pretendon shlyerjen e atij obligimi ose mos ekzistencën e tij, ndërsa i zoti i së drejtës e mohon t'i jetë kthyer e drejta (merret në konsideratë thënia e mohuesit).

3 Nëse është pohuar (vërtetuar) pronësia e dikujt mbi diçka dhe më pas e pretendon dikush tjetër pronësinë e asaj gjëje, ndërkohë që pronari e mohon diçka të tillë (merret për bazë thënia e pronarit të parë).

4 Nëse dikujt i ishte lënë diçka në ruajtje në formë amaneti dhe më pas pretendon dëmtimin apo shkatërrimin e asaj pasurie, ndërkohë që pronari i asaj pasurie e refuzon këtë pretendim. Kjo çështje përfshin personin e autorizuar (vekilin), administratorin e vakfit (nadhiral vakf), kujdestarin e jetimit (velijel jetim), bashkëpronarin në disa nga llojet e bashkëpunimit fitimprurës (pra, kur këta pretendojnë shkatërrimin e pasurisë, ndërkohë që pala tjetër e refuzon këtë pretendim).

5 Nëse personi ngarkohet me dëmshpërbimin e diçkaje që dëmton në dëm të dikujt tjetër dhe më pas bie në mosmarrëveshje me të zotin e së drejtës në lidhje me përcaktimin e vlerës së zhdëmtimit, atëherë do të merret për bazë fjala e tij.

6 Nëse dikush autorizohet për të administruar një pasuri të përbashkët mes tij dhe një tjetri dhe gjatë kësaj kohe blen diçka

ose merr me qira diçka dhe thotë se e ka marrë personalisht për veten e tij, ndërkohë që ortaku tjetër pretendon se ai veprim është i bashkangjitur me pasurinë e tyre, atëherë do të merret në konsideratë thënia e të autorizuarit.

7 Nëse dy persona bien dakord për një lloj akti dhe e përfundojnë, më pas njëri pretendon se akti nuk është korrekt për shkak të mungesës së një kushti, një elementi bazik apo një pengese, ndërkohë që tjetri e refuzon këtë pretendim, do të merret në konsideratë thënia e atij që mbron vlefshmërinë e aktit.

8 Nëse dikush pretendon një kusht të caktuar ose një kufizim specifik ose një përkrahje të caktuar ose një afat etj., ndërkohë që pala tjetër e mohon këtë gjë të pretenduar, atëherë do të merret në konsideratë thënia e mohuesit.

9 Nëse dikush pretendon prishjen e një akti, shitblerjeje ose qiraje apo martese etj., ndërkohë që pala tjetër e mohon diçka të tillë, do të merret në konsideratë thënia e mohuesit.

10 Nëse dikush pretendon diçka shtesë apo mangësi në lidhje me një çështje për të cilën kishin rënë dakord që më parë, atëherë merret në konsideratë thënia e atij që nuk e pranon shtesën apo mangësinë.

11 Nëse dikush ka mbi vete obligime pasurore ndaj të tjerëve për shkaqe të ndryshme (si p.sh. borxh, zhdëmtim, mehr etj.) dhe shlyen një pjesë prej tyre ose ia fal një pjesë pala tjetër dhe më pas bien në mosmarrëveshje në lidhje me sasinë e shlyer apo të falur, do të merret në konsideratë thënia e shlyerësit të obligimit (në rastin e shlyerjes), ndërsa kur i falet do të merret në konsideratë thënia e falësit.

12 Nëse dikush kryen një obligim (jo adhurim fizik) për një tjetër me nijet kthimi (pra, ia lehtëson përkohësisht me kusht që më pas personi t'ia kthejë vlerën e shpenzuar), i takon që t'i kthehet vlera e shpenzuar, por nëse e ka kryer atë obligim pa nijet kthimi, nuk i takon asgjë. Nëse bien në mosmarrëveshje në lidhje me kushtin e kthimit, do të merret në konsideratë thënia e atij që ia kreu obligimin, nëse e kishte me nijet kthimi apo jo.

13 Në përgjithësi çështjet në të cilat njeriu pohon ndaj vetes obligime (borxhe, detyrime, etj), nëse ndodhin mosmarrëveshje, do të merret në konsideratë thënia e pohuesit.

14 Në të gjitha llojet e mosmarrëveshjeve që ndodhin mes njerëzve, nëse njëra prej palëve ka një bazë ku mbështetet (p.sh. parimin e mirënjohur që origjina është se njeriu nuk ka mbi vete obligime, përveçse me argument dhe fakt), atëherë do të merret në konsideratë thënia e kësaj pale. Në të gjitha rastet në të cilat merret në konsideratë thënia e njëres palë, i mjafton kësaj pale që të betohet për vërtetësinë e thënies së tij, n.q.s. pala tjetër nuk sjell argumente dhe fakte bindëse për të kundërtën.

15 Në çështjet e dhuratave dhe çmimeve që ofrohen për personat kundrejt një pune apo shërbimi të caktuar, nëse ka mosmarrëveshje mes ofruesit dhe fituesit, do të merret në konsideratë thënia e ofruesit të çmimit.

Duhet të kemi parasysh se në të gjitha rastet kur merret në konsideratë thënia e njëres palë, kemi kushtin që thënia e tij të mos jetë qartazi në kundërshtim me realitetin konkret apo atë realitet normal të zakonshëm që

njihet mes njerëzve, sepse në këto raste hidhet poshtë fjala e tij dhe merret për bazë vlerësimi i njerëzve ekspertë apo me përvojë në atë fushë apo zakoni mbizotërues në atë bashkësi.

16 Në çështjet në të cilat njeriu shprehet me nënkuptime, si p.sh. në lirinë e robërve apo në divorc (p.sh. i thotë bashkëshortes: ik në shtëpinë e prindërve të tu) etj., do të merret për bazë qëllimi i folësit, nëse kishte për qëllim divorcin apo jo, lirinë nga robëria apo jo, etj.

17 Do të merret në konsideratë thënia e gruas për gjykimet që kanë lidhje me çështjet e menstruacioneve apo të lehonisë apo të shtatzënisë, qoftë për pohimin e diçkaje apo për mohimin e saj. Nëse ndodhin mosmarrëveshje në këtë fushë dhe pala pretenduese nuk ka fakte, do të merret për bazë thënia e gruas.

Marrë nga libri "El fetava es-sa'dijeh", fq. 445-447.

Përshtati: Shuajb Rexha





POZITA E GRUAS NË XHENNET

Xhenneti dhe të mirat e tij nuk janë vetëm për burrat, sepse ai është përgatitur për njerëzit e devotshëm të të dy gjinive, siç na njofton Allahu: “Dhe kushdo që bën vepra të mira, qoftë ai mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në xhennet.” Nisa: 124

Falënderimet i takojnë Allahut, ndërsa salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin tonë, Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij. Duke vërejtur pyetjet e shpeshta të grave rreth pozitës së tyre në xhenet, rreth asaj se çfarë është përgatitur për to, atëherë pata dëshirë të përmblihdja disa dobi të përfutuara dhe të vërtetuara me argumente, të cilat ua sqarojnë atyre këtë temë.

DOBIA E PARË

Nuk duhet të qortohen gratë nëse ato pyesin se çfarë përjetimesh do të ketë për to në xhenet, sepse qenia njerëzore është shumë e lidhur me të menduarit rreth së ardhmes dhe përfundimit të vet. Po ashtu, Pejgamberi nuk i qortonte sahabët për këto lloj pyetjesh kur ata e pyesnin rreth xhennetit dhe gjërave që gjenden në të, bile e pyesnin edhe për ndërtimet në xhenet, kurse Pejgamberi qe përgjigjur: “Një

tjegull është nga ari, kurse tjetra nga argjendi.” Po ashtu është pyetur se a do të takohen me gratë e tyre në xhennet? Ai i njoftoi se ajo gjë do të ndodhë.

DOBIA E DYTË

Qenia njerëzore qoftë mashkull apo femër joshet prej xhennetit kur përmendet ai dhe gjërat e këndshme që janë në të. Kjo është një gjë e mirë, nëse ato joshje nuk janë vetëm iluzione të kota që nuk shoqërohen me vepra të mira, sepse Allahu u thotë besimtarëve: “Ja, ky është xhenneti që ju është dhënë në trashëgim për atë që keni bërë.” Zuhruf: 72 Pra, kur kanë dëgjuar për xhenetin, kanë pasur dëshirë të mëdha për të dhe e kanë vërtetuar me veprat e tyre.

DOBIA E TRETË

Xhenneti dhe të mirat e tij nuk janë vetëm për burrat, sepse ai është përgatitur për njerëzit e devotshëm të të dy gjinive, siç na

njofton Allahu: *“Dhe kushdo që bën vepra të mira, qoftë ai mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në xhennet.”* Nisa: 124

DOBIA E KATËRT

Gruaja nuk duhet të preokupohet me pyetje të shpeshta dhe të hulumtojë rreth detajeve të hyrjes në xhennet, duke pyetur se çfarë do të bëjë atje, ku do të shkojë, si dhe pyetje të ngjashme që të japin përshtypjen se atje ka për të shkuar në një shkretëtirë. Asaj i mjafton ta dijë se posa të hyjë në xhennet do të harrojë çdo vuajtje që ka përjetuar dhe ajo do t'i shndërrohet në lumturi të përhershme. I mjafton fjala e Allahut: *“Aty nuk do t'i mundojë lodhja e prej aty kurrë nuk do të dëbohen.”* Hixhr: 48 Po ashtu fjala e Allahut: *“Aty do të ketë çfarë t'ju dojë shpirti dhe gjithçka që ta kënaq syrin dhe atje do të qëndroni përgjithmonë.”* Para së gjithash mjafton fjala e Allahut: *“Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë.”* Maide: 119

DOBIA E PESTË

Kur Allahu përmend disa lloje ushqimesh, pamjesh dhe pallatesh joshëse, ato i përmend në formë që përfshin edhe mashkullin edhe femrën, pasi të gjithë do t'i gëzojnë ato të mira.

Mbetet për t'u sqaruar ajo se Allahu ka bërë që burrat të joshen prej xhennetit duke ua përmendur (hyrijet) dhe (gratë e bukura), por e njëjta gjë nuk është përmendur për gratë, prandaj gruaja mund të pyesë se për çfarë arsye nuk është bërë kjo edhe për to?

Përgjigje:

1. Allahu *“nuk mund të pyetet për atë që punon, kurse ata do të pyeten.”* Enbija: 23

Por nuk ka gjë të keqe që ta mësojmë urtësinë e kësaj përmes teksteve shariatike dhe parimeve të Islamit, prandaj themi:

2. Siç dihet, turpi është natyrshmëri e grave dhe për këtë Allahu nuk i ka bërë ato të joshen prej xhennetit me ato gjëra prej të cilave turpërohen.

3. Joshja e grave ndaj burrave nuk është e njëjtë me joshjen e burrave ndaj grave, prandaj Allahu ka bërë që burrat të joshen prej xhennetit duke ua përmendur gratë si vërtetim i fjalës së Pejgamberit sal-Allahun alejhi ve sel-lem, i cili thotë: *“Nuk kam lënë pas vetes ndonjë fitne (spruvë) më të dëmshme për burrat sesa Gratë.”* [1]

Kurse sa i përket gruas, Allahu ka bërë që ajo të jetë e joshur prej stolive dhe veshjeve më tepër se ç'është e joshur ndaj burrave dhe kjo është natyrshmëri e saj, siç thotë Allahu: *“Vallë, a është ajo (femra) që rritet në stoli?”* Zuhruf: 18

4. Shejh ibën Utthejmini thotë: “Allahu ua ka përmendur gratë burrave sepse burri është ai që e kërkon gruan dhe për këtë shkak burrave u janë përmendur gratë në xhennet dhe grave nuk u janë përmendur burrat, por kjo nuk do të thotë se gratë nuk kanë burra në xhennet, sepse gjithsesi do të kenë burra atje.

DOBIA E GJASHTË

Sa i përket martesës në dunja, gruaja mund t'i ketë këto raste:

1. Vdes para se të martohet.
2. Vdes pas shkurorëzimit, pa u martuar me tjetër burrë.
3. Martohet, por burri i saj nuk është prej banorëve të xhennetit.
4. Vdes pas martesës.
5. Vdes pas burrit të saj dhe nuk martohet me tjetër pas tij.

[1] Buhariu

6. Vdes pas burrit të saj, duke u martuar me dikë tjetër.

Këto janë gjendjet e gruas në dunja dhe të gjitha këtyre gjendjeve u përgjigjet nga një në xhennet:

1. Sa i përket gruas e cila nuk ka qenë e martuar, Allahu do ta martojë në xhennet me një njeri i cili ka jetuar në dunja, duke u bazuar në hadithin e Pejgamberit, i cili thotë: “Në xhennet nuk do të ketë beqarë.” Lidhur me këtë, shejh Uttejmini thotë: “Nëse gruaja nuk ka qenë e martuar në dunja, Allahu do ta martojë në xhennet me një njeri me të cilin ajo është i kënaqur. Pra, përjetimet e mira të xhennetit nuk janë veçmas vetëm për burrat, por edhe për gratë, kurse ndër përjetimet e xhennetit është edhe martesë.

2. Të njëjtën gjendje do të ketë edhe gruaja e cila ka qenë e shkurorezuar.

3. Po ashtu, këtë gjendje do të ketë gruaja që nuk e ka burrin e saj banor të xhennetit. Lidhur me këtë, shejh Uttejmini thotë: “Nëse gruaja është banore e xhennetit dhe nuk ka qenë e martuar, apo burri i saj nuk është banor i xhennetit, atëherë kur ajo të hyjë në xhennet do të hasë në burra që nuk kanë qenë të martuar në dunja dhe do të martohet me ndonjërin prej tyre.

4. Kurse gruaja e cila ka vdekur pasi është martuar dhe është banore e xhennetit do të jetë grua e po atij burri.

5. Gruaja e cila ka vdekur pas burrit të saj dhe më pas nuk është martuar me tjetër, atëherë në xhennet do të jetë gruaja e po atij burri.

6. Ndërsa gruaja e cila ka vdekur pas burrit të saj, por është martuar me tjetër pas tij, atëherë ajo do të jetë grua e burrit të saj të fundit, duke u bazuar në hadithin e Pejgamberit, i cili thotë: “*Gruaja do të jetë*

bashkëshorte e burrit të saj të fundit.” Sak-tëson Albani. Po ashtu duke u bazuar në fjalët e Hudhejfes kur i drejtohet gruas së tij: “Nëse dëshiron të jesh bashkëshorte e imja në xhennet, atëherë mos u marto me tjetërkënd pas meje, sepse gruaja në xhennet do të jetë bashkëshorte e burrit të saj të fundit që ka pasur në dunja.” Për këtë, Allahu ua ka ndaluar grave të Pejgamberit që të martohen pas vdekjes së tij, sepse ato në xhennet do të jenë bashkëshorte të tij.” Dikush mund të thotë: “Është transmetuar se në duanë e xhenazes së gruas duhet të themi: “O Allah! Zëvendësoja kësaj gruaje burrin e saj me një burrë më të mirë”, atëherë si mund të lutemi për këtë grua kur e dimë se burri saj në dunja do të jetë edhe në xhennet me të, po ashtu nëse gruaja ka qenë e pamartuar, ku do të jetë burri i saj?

Përgjigje: Shejh Uttejmini thotë: “Nëse ka qenë e pamartuar, atëherë është për qëllim që Allahu t’ia zëvendësojë burrin e saj që ka pasur në dunja me një më të mirë në xhennet. Por nëse ka qenë e martuar, atëherë është për qëllim që burri i saj në xhennet ka cilësi më të mira sesa kur ka qenë në dunja, sepse në ahiret do të ndërrohen gjërat, sikurse thotë Allahu: “*Ditën, kur toka do të ndërrohet me tokë tjetër, por edhe qiejt.*” (Ibrahim: 48) Pra, në ahiret do të jetë po kjo tokë, vetëm se do të shtrihet.

DOBIA E SHTATË

Është transmetuar në hadithin e vërtetë se Pejgamberi u ka thënë grave: “*Unë kam parë se banorët më të shumtë të xhehennemit jeni ju*”, kurse në një hadith tjetër: “*Banorët më të pakët të xhennetit janë gratë.*” Transmeton Buhariu dhe Muslimi. Kurse në një hadith

tjetër është transmetuar të ketë thënë: “Çdo burrë në xhennet do t’i ketë nga dy gra”. Për këtë qëllim dijetarët kanë mendime të ndryshme lidhur me këtë, se a do të ketë më shumë gra në xhennet apo në xhehenem?

Disa kanë thënë se gra do të ketë më shumë në xhenet, po ashtu edhe në xhehenem për shkak të numrit të madh të tyre. Kadi Ijadi thotë: “Numri më i madh i bijve të Ademit janë gra.”

Disa kanë thënë se duke u bazuar në hadithet e Pejgamberit, më shumë gra do të ketë në xhehenem, por edhe në xhennet do të ketë më shumë, nëse llogariten së bashku me hyriat.

Kurse të tjerët kanë thënë se fillimisht në xhehenem do të ketë më shumë gra, më pas do të bëhen banorët më të shumtë të xhennetit pasi të dalin nga zjarri (muslimanet).

Duke e komentuar fjalën e Pejgamberit: “Unë kam parë se banorët më të shumtë të xhehenemit jeni ju.” Kurtubiu thotë: “Kjo ka mundësi të jetë në kohën kur disa prej grave të jenë në xhehenem, kurse pasi të dalin nga xhehenemi me ndërmjetësimin e Pejgamberit dhe me mëshirën e Allahut deri atëherë kur nuk do të mbetet në zjarr askush që thotë “La i lahe ilalAllah”, atëherë gratë do të bëhen numri më i madh i banorëve të xhennetit.

Por esenca është që gruaja të jetë e kujdesshme që të mos bëhet nga banorët e xhehenemit.

DOBIA E TETË

Kur gruaja të hyjë në xhennet, Allahu do t’ia kthejë rininë dhe virgjërinë e saj, duke u bazuar në hadithin e Pejgamberit, i cili thotë: “Në xhennet nuk do hyjë asnjë grua


duke qenë e vjetër në moshë... , por Allahu do t’i shndërrojë ato në të virgjëra.”

DOBIA E NËNTË

Ky është xhenneti që është zbukuruar për ju gra, sikurse është përgatitur edhe për burrat, prandaj kujdesuni që të mos e humbni rastin sepse jeta është e shkurtër dhe pas saj vjen përjetësia, andaj le të jetë përjetësia juaj në xhennet. Duhet ta dini se mehri i xhennetit është imani dhe veprat e mira e nuk janë iluzionet e kota duke qenë neglizhente në veprat tuaja. Kujtoni fjalën e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili thotë: “Kur gruaja i fal pesë namazet, e agjëron Ramazanin, e ruan nderin e saj dhe respekton burrin, asaj do t’i thuhet hyj në xhennet nga cila derë të duash.” Të kini kujdes thirrësit e prishur dhe shkatërrues të femrës, të cilët duan t’ju largojnë nga fitorja e xhennetit. Mos u mashtroni me shprehjet dhe zbukurimet që ju bëjnë liberalistët dhe liberalistet në mjetet e ndryshme të informimit sepse për këta njerëz Allahu thotë: “Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni, ashtu siç nuk besojnë vetë dhe të bëheni të njëjtë me ata.” Nisa: 89 Lus Allahun që t’ju japë sukses grave të muslimanëve në fitoren e xhennetit, t’i udhëzojë ato dhe t’i bëjë udhëzuese për të tjerët dhe t’ua largojë shejtanët njerëz, të cilët bëjnë thirrje për shkatërrimin e gruas. Salavatet dhe selamet tona qofshin mbi të Dërguarin tonë, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Përshtati: Jeton Bozhlani

DISA ÇËSHTJE NË LIDHJE ME AKIKËN



Transmetohet nga Ebu Rafsu, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se ka thënë: "E kam parë të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem të thërrasë ezanin në veshin e Husejnit në kohën kur e lindi Fatimja." Hadithi është i dobët, e ka nxjerrë Ebu Davudi 5105, Tirmidhiu 1514, Ahmedi, Hakimi 3/179, Begaviu në "Sherh es Sunneh" 11/273/2822, Bejhakiu në "es-Sunenul Kubra" 5/305 dhe në "Shuabul Iman" 8617-8618, Abdurrazaku në "Musan-nef" 7986 etj.

1. Nëse personit nuk i është bërë akikah kur ka lindur, a duhet të bëj ai akikah për veten e tij kur të rritet?

Disa kanë anuar nga mendimi se lejohet që personi të bëj akikah për veten e tij, duke u bazuar në transmetimin e Enesit: "se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem bëri akikah për veten e tij pas dërgimit (si Profet dhe i Dërguar)."

Këtë e ka nxjerrë El Bejhakiu në "es-Sunenu el Kubra" 9/300 dhe ka thënë: "Ky hadith është i urryer."

Ndërsa Neveviu në "El Mexhmu'u" 8/412 ka thënë: "Ai është hadith i kotë dhe Abdullah ibën Muharrar (njëri prej burrave të senedit) është i dobët dhe kanë rënë dakord për dobësinë e tij."

Ndërsa Hafidh Ibën Haxher ka thënë: "Ai është metruk (që nuk i merret ha-

dithi)."

Për më shumë shih fjalët e dijetarëve në lidhje me Abdullah ibën Muharrar në: "Et Tarihul Kebir" 3/1/212, "El Xherhu vet Tahdil" 5/176, "El Mizan" 2/500 dhe "Et Takrib" 1/445.

Imam Albani, Allahu e mëshiroftë, në studimin që i ka bërë këtij hadith ka dalë në konkluzionin se ekziston një rrugë e cila e bën të saktë këtë hadith. Ky hadith transmetohet nga Enesi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, nga dy rrugë: rruga e parë është ajo që e transmeton nga Enesi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, Abdullah ibën el Muharrari dhe ky nga Katadeh. Porse Abdullah ibën Muharrar është shumë i dobët (siç e kemi cekur edhe më sipër). E ka nxjerrë Abdurrazaku në "Musannefin" e tij 4/329/7960 dhe prej rrugës së tij e ka nxjerrë Ibën Hibani në "Ed Du'afa" 2/33.

Ndërsa rrugën tjetër të transmetuar prej Enesit e ka nxjerrë Tahaviu në "Mushkilul Athar" 1/461, Taberaniu në "El Mu'xhemul Evsat" 1/55/2 me nr. 976 dhe Ibën Hazmi në "El Muhal-la" 8/321. Them (Albani): "Isnadi është i mirë."

Pra, imam Albani, Allahu e mëshiroftë, është i mendimit se akikah është vaxhib dhe se prindi i fëmijës duhet ta bëjë këtë. Por nëse prindi i fëmijës nuk e bën (duke i pasur mundësitë), atëherë merr gjynah për lënien e vaxhibit. Ndërsa fëmija, kur të rritet, është e pëlqyeshme që të bëjë akikah për veten e tij (nëse prindi nuk ia

ka bërë). Allahu e di më së miri!

2. Prej sunnetit është që fëmijës së porsalindur t'i jepen hurma si dhe t'i vendoset një emër i bukur.

Transmetohet nga Ibën Umeri, Allahu qoftë i kënaqur me ta, se ka thënë: "I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Me të vërtetë prej emrave tuaj më të dashur tek Allahu i Madhëruar janë Abdullah dhe Abdurrahman." Sahihu Muslim 2132^[1]

Transmetohet nga Enesi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se Umu Sulejmi lindi një djalë. Në atë kohë Ebu Talha më tha mua: "Mbaje dhe shko me të tek i Dërguari, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem." Ai shkoi me të tek i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe e ëma i kishte dhënë me vete edhe disa hurma. "I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i mori ato dhe i përtypi me gojë, pastaj i nxori nga goja dhe i futi në gojën e të porsalindurit për të përcjellë diçka prej tyre dhe e quajti Abdullah." Buhariu dhe Muslimi

Transmetohet nga Sehl ibën Seadi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se ka thënë: "Kur lindi Mundhir ibën Usejdi, e sollën tek i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili e mori dhe e vuri në prehër, ndërsa Ebu Usejdi ishte ulur aty pranë. I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem filloi të merrej me diçka që kishte mes duarve dhe Ebu Usejdi urdhëroi që ta merrnin birin e tij nga prehri i të Dërguarit sal-lAl-

[1] Shih dhe "El Edhkar" të imam Neveviut me recensim të shejh Selim el Hilali, vëll. II, f. 628.

lahu alejhi ve sel-lem. Atëherë i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem filloi të pastrojë dhëmbët me misvak dhe tha: "Ku është fëmija?" Ebu Usejdi tha: "O i Dërguari i Allahut, e kthym (tek e ëma)." Ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: "Si e ka



emrin ai? Ai tha: "Filani" (tha një emër). Ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: "Por emri i tij është Mundhir." Atëherë ai ia vuri emrin Mundhir." Buhariu 6191, Muslimi 2149.

Ndërsa sot gjen disa muslimanë që fëmijët e tyre i emërtojnë me emra të huaj apo me emra të cilët nuk ka asnjë lloj kup-

timi, duke i lënë kështu emrat e njohur në shoqërinë e tyre (muslimanëve), siç janë p.sh.: emrat e të Dërguarve të Allahut, emrat e sahabëve etj., prej emrave të bukur.

3. Nuk lejohet që me gjakun e akikës të lyhet koka e fëmijës sepse një veprim i tillë është vepër e kohës së injorancës.

Unanimisht është i urryer një veprim të tillë, duke u argumentuar me hadithin që transmeton nëna e besimtarëve, Aisha, Allahu qoftë i kënaqur prej saj, të cilin e ka nxjerr Ibën Hibani në "Sahihun" e tij me nr. 5308, Ebu Ja'la me nr. 4521 dhe Bejhekiu 9/303 me sened të vërtetë.

Gjithashtu transmetohet nga Jezid ibën Abdullah ibën el Muzeni se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Bëhet kurban për fëmijën dhe nuk preket (lyhet) koka e tij me gjak."

E ka nxjerrë Ibën Maxheh në "Sunenin" e tij me nr. 3166, Tahaviu në "Mushkilul athar" 1/460, Taberaniu në "El Evsat" me nr. 333 gjithashtu dhe në "El Kebir" siç është në "Mexhmu' ez Zevaid" 4/85.

Transmetohet nga Burejde el Eslemi se ai ka thënë: "Nëse ndokujt prej nesh i lindte djalë në kohën e injorancës (paraislame), ai therte një dash dhe me gjakun e tij lyente kokën e foshnjës. Kur Allahu zbriti Islamin, ne thernim dash për të porsalindurin, i rruanim kokën dhe ia lyenim atë me zeaferan (një lloj bime me aromë të mirë)." [2]

[2] Ebu Davudi në "Sunenin" e tij me nr. 2843 me sened të mirë.

Atau ka thënë: “Në fillim fillohet me rruajtjen e kokës para therjes.

Ndërsa në librin "El Ikna" në medhhebin hanbeli thuhet: "Prej sunnetit është që ditën e shtatë të lindjes t'i rruhet e gjithë koka dhe kjo bëhet pas therjes së akikës."

Ibën Abdulberri në "Et Temhid" 4/318 ka thënë: "Nuk dimë asnjë prej dijetarëve që të thotë "bëhet koka e fëmijës me gjak" përveç Hasenit dhe Katades, të cilët kanë thënë: "Lyhet koka e fëmijës (foshnjës) me gjakun e akikës."

Prej dijetarëve që e kanë urryer një veprim të tillë janë: imam Ahmedi, Zuhriu, Maliku, Shafiu dhe Ibën Mundhiri. Shih "El Mugni" 13/398 dhe "El Mexhmu'u" të imam En Neveviut 8/431

4. Kur duhet bërë akikah (në cilën ditë)?

1. Hadithi i Semurah bin Xhundubit: "Çdo fëmijë është peng i akikës së tij, e cila theret për të në ditën e shtatë të lindjes, ditë në të cilën atij i rruhet koka, i vihet edhe emri." E kanë transmetuar të pestët (është për qëllim me të pestët, pesë të tjerët prej grupit, duke përjashtuar Buhariun dhe Muslimin). E ka saktësuar hadithin Tirmidhiu.^[3]

2. Amër ibën Shuajbi transmeton nga babai i tij, nga gjyshi i tij, se "i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka urdhëruar që foshnjës t'i vihet emri në ditën e shtatë

të lindjes, t'i rruhen flokët e kokës dhe të theret akika për të." Transmeton Tirmidhiu dhe thotë: "Ky hadith është i hasen garib."

Gjithashtu Tirmidhiu në "Sunenin" e tij 4/101 ka transmetuar nga dijetarët se ata e pëlqenin që të theret (bëhet akikah) në të shtatën ditë; nëse nuk mundesh, në të 14-tën dhe nëse nuk mundesh (edhe në këtë ditë), atëherë në ditën e 21-të.

Argument për këtë është hadithi që ka nxjerrë Bejhëkiu në "es-Sunenul Kubra" 9/309 nga Abdullah ibën Burejdedh dhe ky nga babai i tij, se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Akikah theret në të shtatën, në të katërmbëdhjetën dhe në të njëzetënjëtën."

5. Kur lind fëmija, në veshin e tij të djathtë nuk këndohet ezani dhe as ikameti.

Transmetohet nga Ebu Rafiu, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se ka thënë: "E kam parë të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem të thërrasë ezanin në veshin e Husejnit në kohën kur e lindi Fatimja." Hadithi është i dobët, e ka nxjerrë Ebu Davudi 5105, Tirmidhiu 1514, Ahmedi, Hakimi 3/179, Begaviu në "Sherh es Sunneh" 11/273/2822, Bejhakiu në "es-Sunenul Kubra" 5/305 dhe në "Shuabul Iman" 8617-8618, Abdurrazaku në "Musannef" 7986 etj.

[3] Ahmedi 5/7-8, 12, 17-18 dhe 22. E ka nxjerrë Ebu Davudi 2835 me nr. (2838), Tirmidhiu me nr. 1522, Nesaiu me nr. 4220, Ibën Maxheh me nr. 3165, Ibën Abdulberri në "Et Tehmid" 4/307, Tajalsiu me nr. 909, Tahaviu 1/453, Darimiu 2/81, Bejhakiu 9/299, Taberaniu në "El Kebir" vëll. VII, me nr. 6827-6832 dhe Hakimi 4/237 dhe tha: "Isnadi është i vërtetë, kështu ka thënë dhe Edh Dhehebiu."

Transmetohet nga Hasen ibën Ali, Allahu qoftë i kënaqur me ta, nga Profeti sal-Allah alejhi ve sel-lem se ka thënë: “Kush shtohet me fëmijë dhe e thërret ezanin në veshin e tij të djathtë dhe ikametin në veshin e majtë...”

Shejh Selim el Hilali thotë: “hadithi është i rrejshëm.”

Po ashtu transmetohet nga Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me ta, porse ai është i rrejshëm.

Shejh Albani, Allahu e mëshiroftë, hadithin që transmeton Ebu Rafiu (më sipër) e ka bërë të mirë në “Ed Daifeh” 1/331/321 duke u nisur nga hadithi që transmeton Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me ta, duke thënë: “Mundet që hadithi të cilin e transmeton Ebu Rafiu të forcohet me hadithin e Ibën Abasit.”

Shkaku që shejh Albani, Allahu e mëshiroftë, e ka bërë të mirë hadithin e Ebu Rafiut është se ai ka ndjekur në të Ibën Kajimin, ngase libri i Bejhakiut “Shuabul Iman” nuk ka qenë i botuar në atë kohë. Porse kur shejhut, Allahu e mëshiroftë, i ra në dorë senedi i këtij hadithi, pasi u botua libri i Bejhakiut, iu bë e qartë atij dobësia e madhe (e hadithit të Ebu Rafiut) dhe u kthye nga gjykimi i tij i mëparshëm.

I njëjti gjykim vlen edhe për këndimin e ikametit në veshin e majtë të fëmijës së

porsalindur, një gjë është e tillë është e shpikur dhe nuk saktësohet. Shejh Selim el Hilali, Allahu e ruajttë, në recensimin që i ka bërë librit të imam Neveviut “El Edhkar” ka thënë se “senedi i këtij hadithit^[4] është i rrejshëm”.

Shënim:

Shejh Selim el Hilali thotë: “Nuk saktësohet ndonjë hadith apo ether nga sahabët për këndimin e ezanit në veshin e fëmijës së porsalindur. Porse transmetohet nga Umer ibën Abdulazizi dhe e ka nxjerr Abdurrazaku në “Musanef” 7895, porse isnadi i tij është shumë i dobët.”

6. Akikah ka të njëjtin gjykim si kurban i Bajramit^[5].

Imam Maliku dhe imam Shafiu janë të mendimit se akikah ka të njëjtin gjykim si kurban i Bajramit. Kërkohej që kurban i akikës të plotësojë të gjitha kushtet (cilësitë) që duhen për kurbanin e Bajramit. Pra, kurban i nuk duhet të ketë dëmtime, hahet prej mishit të tij e jepet sadaka si dhe i dhurohet komshiut, mishi i tij nuk shitet e as lëkura si dhe nuk i thyhen kockat. Me këtë mendim janë dhe Ahmedi, Theuriu dhe një grup prej dijetarëve. Ebu Umeri ka thënë: “Në këtë kanë shkuar shumica prej fukahave.” (“El Istidhkar”)

Përgatiti: Xhabir Sheme

[4] Hadithi është: “Transmetohet nga Husejn ibën Ali, Allahu qoftë i kënaqur me ta, se ka thënë: “I Dërguari i Allahut sal-Allah alejhi ve sel-lem ka thënë: “Nëse ndonjërit i lind fëmijë, atëherë le të këndojë në veshin e tij të djathtë ezanin, ndërsa në veshin e tij të majtë ikametin...” i shpikur, Shih “El Edhkar” të imam Neveviut me recensim të shejh Selim el Hilalit, vëll. II, f. 623.

[5] Shih “El Mugni”.

ÇFARË KUPTOJMË ME TERMIN “SELEFI”

Ibën Tejjmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Nuk është turp për dikë që shfaq metodën e selefëve të singertë dhe i atribuohet atyre dhe krenohet me ta, duke qenë i kënaqur pa përjashtime. Pa dyshim se rruga e selefëve të singertë nuk është diçka tjetër pos së vërtetës.”



Falënderimi i takon Allahut, kurse paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të Dërguarin e Tij, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe pasuesit e tij me të drejtë dhe ata që ndjekin rrugën e tyre deri në Ditën e Gjykimit.

Me fjalë të pakta, por me kuptime madhore kërkojmë nga Allahu i Madhëruar të na japë sukses dhe që kjo punë të lërë gjurmë në jetën e përditshme, duke qartësuar rrugën e drejtë e cila na çon tek Allahu dhe metodën e pastër me të cilën Allahu është i kënaqur.

Në kohën tonë janë shtuar grupimet dhe partitë e shumta islame, duke mos harruar rrugët e sufive (dervishëve), të cilët dolën në kohën kur janë shtuar grupimet që pretendojnë se janë në të qëlluarën, grupime që thërrasin në besimin dhe metodologjinë e tyre e që vazhdojnë të lavdërojnë njëra-tjetrën. Ky realitet u është përzier tani njerëzve, që nuk dinë se kë të marrin si model apo cila është e mira dhe cila e keqja.

Mirëpo falënderimi i takon Allahut, që mundëson të vazhdojë e mira në këtë ummet, saqë do të vazhdojë një grup nga

ky ummet i kapur pas udhëzimit dhe realitetit deri në shkatërrimin e botës, ashtu siç ka ardhur në hadith të vërtetë nga i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *“Do vazhdojë një grup nga ummeti im triumfues me të drejtën, duke mos u penguar nga ata që e injorojnë, derisa të vijë caktimi i Allahut e ata të jenë në këtë gjendje.”*

Nga këtu pra është obligim i yni të njihemi me këtë grup të shpëtuar dhe palë të ndihmuar, e cila i përmbahet Islamit të pastër ashtu siç iu shpall të Dërguarit të Allahut, siç e praktikoi gjenerata e sahabëve e pastaj tabiinët dhe pasuesit e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit. Lus Allahun të jemi prej tyre!

Ky grupim quhet ndryshe edhe “Pasuesit e Sunnetit dhe Xhematit” ose “Pasuesit e hadithit dhe gjurmëve”, ose “selefite”. Këta janë ata që vazhdojnë rrugën e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe të shokëve të tij.

Tani është e qartë se ata që i etiketojnë “selefite” me etiketime negative, se gjoja janë një pjellë e re, bëjnë një etiketim të gabuar ngase “selefite” i atribuohen selefëve të sinqertë, d.m.th. sahabëve të të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Ata janë pasuesit e Sunnetit dhe Xhematit dhe atribuimi tek ata është diçka e pëlqyer e kurrsesi nuk është diçka e re.

Ibën Tejjmije, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Nuk është turp për dikë që shfaq metodën e selefëve të sinqertë dhe i atribuohet atyre dhe krenohet me ta, duke qenë i kënaqur pa përjashtime. Pa dyshim se rruga e selefëve të sinqertë nuk është diçka tjetër pos së vërtetës.”

Kush ka sadopak njohuri në gjuhën arabe e kupton se fjala selef gjuhësisht do të

thotë diçka që ka kaluar, d.m.th. ka kaluar me dituri, besim, respekt dhe mirësi.

Ibën Mendhuri thotë: “Selef janë paraardhësit e tu, prindërit, gjyshërit apo dikush që është më i moshuar dhe më i respektuar se ti. Për këtë u quajt edhe gjenerata e parë dhe pasardhësit e tyre si selefë të sinqertë.” I Dërguari i Allahut i ka thënë vajzës së tij Fatimes, Allahu qoftë i kënaqur me të: “Sa selef i mirë jam për ty.”

Pra, i Dërguari i Allahut, sahabët dhe pasuesit e tyre më të mirë janë selefët e këtij ummeti dhe çdokush që bën thirrje në atë që ka thirrur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, sahabët dhe pasuesit e tyre më të mirë, ai është në metodën e selefëve të drejtë.

Për këtë ai quhet selef, d.m.th. i atribuohet atyre dhe me këtë emërtim dallohet nga grupimet e devijuara nga metoda e selefëve. Krenaria i takon çdo muslimani që praktikon metodën e tyre, që t’u atribuohet selefëve të mirë.

Nisur nga kjo, është obligim i çdo muslimani që të jetë selef i drejtë, ngase bazat e muslimanit kthehen tek udhëzuesi më i mirë, tek Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e pastaj te sahabët, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Kush tërhiqet nga ky kuptim i kësaj fjale, kërkojmë nga Allahu ta rikthejë tek e qëlluara dhe ta udhëzojë në rrugën e drejtë.

Me këtë sqarim u bë e qartë se termi “selef” është argument i qartë për pasuesin e mirëfilltë të rrugës së selefëve të sinqertë në marrjen e Islamit dhe metodën e praktikimit të tij, prandaj le ta dijë muslimani që krenohet me ndjekjen e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem se fjala “selef” është përdorur nga dijetarët eminentë, të hershmit dhe bashkëkohorët. Ishte dhe

është krenari dhe lëvdatë cilësimi me këtë emërtim për atë që pason Sunnetin e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe ndjek kuptimin e sahabëve dhe metodën e tyre hyjnore.

Historiani islam imam Dhehebiu e lavdëronte imam Daru Kutniun duke thënë: “Nuk është zhytur asnjëherë në filozofi e as nuk është zhytur në polemika të shumta, por ishte selefi.”

Pastaj lavdëronte librin “Akidetu el vasitije” duke thënë: “Ai është besimi i mirë selefi.”

Hafith ibën Rexhebi e lavdëronte librin “Akidetu el vasitije” duke thënë: “Ai është besimi sunit selefi.”

Dije vëlla musliman selefi se rruga e pasuesve të Sunnetit dhe Xhematit “selefi” përmban tri baza madhore:

1. Libri i Allahut- Kur’ani i Madhëruar
2. Sunneti Pejgamberik, fjalë dhe vepër dhe gjithçka me të cilën ka ardhur i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem.
3. Metoda e sahabëve, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Për tri gjeneratat e para i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Njerëzit më të mirë janë gjenerata ime, pastaj ata që vijnë pas tyre e pastaj ata që vijnë pas tyre.”*

Me këtë u kuptua qartë se përngjasimi me selefët është lëvdatë dhe mirësi për këdo që merr shembull metodologjinë e tyre, ngase ata janë pishtarët e këtij ummeti, të dëshmuar me gjuhën e të Dërguarit të Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem.

Mirëpo të etiketohesh me këtë emër duke mos e praktikuar metodën dhe besimin e tyre, qoftë ai i jashtëm apo shpirtëror i brendshëm, nuk është lëvdatë dhe mirësi, ngase esenca është tek praktikimi dhe jo te shprehja.

Nga kjo kuptojmë se kushdo që pretendon dhe thërret në selefizëm patjetër duhet të jetë i përkushtuar, i vendosur dhe praktikues i çdo gjëje që ka ardhur prej tyre, si dispozitat, normat, edukata dhe shitblerjet, duke u munduar që të praktikohet Sunneti i të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem sipas metodës së sahabëve, Allahu qoftë i kënaqur me ta.

Ndoshta pyetësi pyet: Pse vetëm metoda e selefit?

Kësaj pyetjeje i përgjigjet muhadithi i kohës, dijetari i madh Muhamed Nasirudin Albani, Allahu e mëshiroftë, i cili thotë: “Bazat e thirrjes selefite janë tri: Kur’ani i Madhëruar, Sunneti i vërtetë dhe të kuptuarit e këtyre të djave sipas metodës së selefëve të sinqertë nga sahabët, tabiinët dhe pasuesit e tyre.”

Shkaqet kryesore të devijimit të shumë grupimeve të mëhershme dhe grupimet bashkëkohore janë mospërfillja e këtyre tri bazave.

Hadithi i të Dërguarit të Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: “Do të ndahet ummeti im në shtatëdhjetë e tre grupe, të gjitha në zjarr, përveç njërit.” Pyetën se cila është ajo. Ai tha: “Ai që vazhdon në atë që jam unë dhe shokët e mi.”

Thotë Albani: “Pra shenjat e këtij grupi të shpëtuar janë ato që ka përmendur i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem kur u pyet për të, domethënë “ai që vazhdon në atë që jam unë dhe shokët e mi.”

Pra, hadithi është një vizion shumë i qartë për atë që dëshiron të dijë rrugën e drejtë, i cili duhet të dijë dhe të ketë parasysh këto dy gjëra:

1. Kush ka qenë Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem.
2. Kush kanë qenë sahabët e Pejgamberit

sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, pra selefët, ngase sahabët e nderuar janë ata që transmetuan tek ne udhëzimin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, janë ata që jetuan dhe praktikuan në vepër Sunnetin. Ne nuk kemi mundësi ta njohim Sunnetin e vërtetë të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem vetëm se përmes tyre, Allahu qoftë i kënaqur me ta.

Dijetari i madh, AbdulAziz ibën Bazi, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Kush mendon të përmirësojë shoqërinë islame apo edhe shoqëri të tjera në këtë dunja jo sipas rrugës dhe metodave që përdorën të parët, vetëm se ka gabuar dhe ka thënë jo të vërtetën.

Kjo dëshmon qartë se Islami i vërtetë nuk ka rrugë tjetër të kuptuari pos asaj të sahabëve, Allahu qoftë i kënaqur me ta, dhe praktikimi i tyre dmth sahabëve i fesë madhore të transmetuar nga Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, qoftë me fjalë, vepër apo pëlqim.”

Pas kësaj themi dhe jemi të bindur se çdo grupim apo shoqëri që nuk ngrihet mbi këto bazamente, d.m.th. Kur’an, Sunnet dhe sipas kuptimit të selefëve të sinqertë, me një studim të gjerë duke përfshirë të gjitha rregullat e Islamit, të mëdhatë apo të voglat, ato primare apo sekondare, grupimi ose shoqëria e tillë nuk është nga grupi i shpëtuar, i cili ecën rrugës së drejtë që përfshihet në hadithin e vërtetë të Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Nëse mendojmë se ka grupime të shumta në vendet islame të bazuara mbi këto bazamente, d.m.th. metodën e pasuesve të Sunnetit dhe Xhematit, këto pra nuk janë parti apo lëvizje, por ky është xhemati i bashkuar në metodën e selefëve të sinqertë, rruga e tyre është e përbashkët. Pra, sh-

përndarja e tyre nëpër shtete të ndryshme nuk është ndarje e bindjeve dhe e mendimeve, por thjesht është ndarje e shteteve, kundër atyre grupimeve dhe partive që janë në një shtet të përbashkët, mirëpo të ndarë në grupe të ndryshme.

Vëlla musliman, motër muslimane!

Nëse dëshiron të jesh nga të ngriturit për të mirë në mesin e njerëzve duke qenë krenar e të mos qash për ditët dhe netët e tua, atëherë paso rrugën dhe metodën e pasuesve të Sunnetit dhe Xhematit. Islami është i plotë, pa mangësi, dispozitat e tij janë të lidhura njëra me tjetrën. Shtimi në të është tradhti, ndërsa mangësimi është mohim i dispozitave; pra çdo e re në fe, qoftë ajo mangësi apo shtojcë, është e refuzuar nga kushdo qoftë.

Kërkoj nga Allahu i Madhëruar të na bëjë pasues të selefëve duke ndjekur rrugën e pasuesve të Sunnetit dhe Xhematit, duke na furnizuar me sinqeritet në fjalë dhe vepër!

Kërkoj nga Ai që t’i udhëzojë të gjithë muslimanët në rrugën e drejtë dhe metodën e qëlluar, t’i bashkojë rreshtat dhe fjalët e tyre, t’ia kthejë ummetit krenarinë dhe nderin që kishte!

Falënderimi i takon Zotit të botëve.

*Shkruar nga Muhna Naim Nexhem Ebul Harith
Anëtar i organizatës së dijetarëve dhe thirrësve në
Palestinë*

Përshtati: Unejs Murati

TRASHËGIMIA në Islam

Apo në detaje siç thuhet në fjalën e Allahut: "Allahu ju urdhëron për (çështje të trashëgimisë) fëmijët tuaj: mashkullit i takon aq sa u takon dy femrave. E nëse janë më shumë se dy femra, atyre u takojnë dy të tretat nga ajo që ka lënë e nëse është vetëm një (femër), asaj i takon gjysma..." Nisa: 11

Falënderimi i takon Allahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu, s'ka kush e lajthit dhe kë e largon nga rruga e vërtetë, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut, i Cili është një dhe pa shok. Gjithashtu dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij.

"O ju që keni besuar, kini frikë Allahun me një frikë të denjë dhe mos vdisni, pos duke qenë muslimanë!" Alu Imran: 102

"O ju njerëz! Keni frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje dhe nga ajo krijoj palën e saj, e prej atyre të dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe kini frikë Allahun, që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisën, se Allahu është mbikëqyrës mbi ju." Nisa: 1

"O ju besimtarë, kini frikë Allahun dhe thoni fjalë të drejta. Ai (Allahu) ju mundëson të bëni vepra të mira, jua shlyen mëkatet tuaja, e kush respekton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ka shpëtuar me një shpëtim të

madh." Ahzab: 70:71

Thënia më e vërtetë është thënia e Allahut, kurse udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem. Veprat më të këqija janë ato të shpikurat, çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është lajthitje, e çdo lajthitje çon në zjarr...

Para se të fillojmë me sqarimin e bazave të shkencës së trashëgimisë, do të paraqesim me lejen e Allahut një pasqyrë të shkurtër të saj në kohën e injorancës për të vërejtur dallimin e madh mes asaj që ka caktuar Allahu^[1] dhe asaj që ishte në atë kohë.

Nga urtësia e Allahut të Lartësuar në jetën e kësaj bote është që çdo gjëje do t'i vijë fundi e do të shkatërrohet, përveç Allahut, Zotit të botëve. Jeta në këtë botë nuk është e përhershme dhe pasuria e njeriut pas vdekjes bartet tek dikush tjetër, por tek kush? Në këtë aspekt ndryshojnë ligjet e kohës së injorancës nga ligji i drejtë islam. Në parimet e kohës së injorancës pasuria e të vdekurit bartet vetëm tek fëmijët e tij të mëdhenj. E, nëse nuk ka, atëherë te vëllai apo xhaxhai i tij, kështu që nuk trashëgojnë të vegjlit e as femrat, me pretekstin se

[1] Përmasat e caktuara nga Allahu (sh.p.).

këta nuk i preokupon nderi familjar e as nuk luftonin e as nuk merrnin plaçkë luftime. Këtë e sqaron edhe më tepër ajo që është transmetuar nga Ibën Abbasi Allahu qoftë i kënaqur me ta, i cili ka thënë: "Kur zbritën përmasat e trashëgimisë që Allahu i ka caktuar, ajo që është caktuar për fëmijën mashkull e femër apo për prindërit, njerëzit apo disa prej tyre e urryen një gjë të tillë dhe thanë: "T'i jepet gruas një e katërta apo një e teta e t'i jepet vajzës gjysma,^[2] e t'i jepet fëmijës së vogël (djalit), përderisa ai nuk është prej atyre që luftojnë apo që merr plaçkë luftime?! Heshtni nga kjo bisedë dhe ndoshta Resulullahu sal-Allahu alejhi ve sel-lem do t'i harrojë këto përmasa (caktime) apo t'i themi (ankohemi) atij diçka e ai t'i ndërrojë përmasat." Disa prej tyre thanë: "O i Dërguar i Allahut, si t'i japim vajzës gjysmën e asaj që ka lënë babai i saj përderisa ajo nuk e shalon kalin (për luftë), e t'i japim të voglit prej trashëgimisë përderisa ajo nuk i bën dobi atij?!" Kështu vepronin në kohën e injorancës, duke ia dhënë trashëgiminë vetëm atij që lufton dhe atij që është më i madh se tjetri.^[3] Kështu ishte mentaliteti në kohën e injorancës, kur i ndalonin prej trashëgimisë ata që kishin të drejtë në të. Më pas erdhi ligji i drejtë islam, që i hodhi poshtë me themel parimet e trashëgimisë së kohës së injorancës në përgjithësi, siç thotë Allahu i Lartësuar: *"Meshkujve u takon pjesë nga pasuria që lënë prindërit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave u takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit, qoftë ajo pak apo shumë ajo që lënë, ju takon pjesë e caktuar (nga Zoti)." Nisa: 7*

Apo në detaje siç thuhet në fjalën e Al-

lahut: *"Allahu ju urdhëron për (çështje të trashëgimisë) fëmijët tuaj: mashkullit i takon aq sa u takon dy femrave. E nëse janë më shumë se dy femra, atyre u takojnë dy të tretat nga ajo që ka lënë e nëse është vetëm një (femër), asaj i takon gjysma..." Nisa: 11*

Kurse sa u përket bashkëshorteve (grave), Allahu i Lartësuar thotë: *"Atyre (grave) u takon një e katërta nga ajo që lini ju, nëse nuk keni fëmijë, por nëse keni fëmijë, atyre u takon një e teta nga ajo që lini ju..." Nisa: 12*

Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë: *"Nëse vdes një njeri që nuk ka fëmijë, por ka motër, atëherë asaj (motrës) i takon gjysma e pasurisë që ka lënë. Ai (vëllai) e trashëgon tërë atë (që lë motra) nëse ajo nuk ka fëmijë. Në qoftë se ato janë dy (motra që trashëgojnë), atyre të dyjave u takojnë dy të tretat që lë ai, nëse trashëgimtarët janë vëllezër e motra, atëherë mashkullit i takon trashëgim sa dy femrave (motrave)." Nisa: 176*

Ky është fillimi i përgjithshëm, kur Islami i dha femrës të drejtën e trashëgimisë që katërmbëdhjetë shekuj më parë, sikurse burrave që merrnin trashëgiminë që nga fillimi, ashtu siç i ka ruajtur të drejtat e të vegjëlve, të cilëve në kohën e injorancës u bëhej padrejtësi dhe e hanin të drejtën e tyre... S'ka dyshim se ky ligj (ligji islam) i trashëgimisë është ligj i drejtë i cili është në pajtim me natyrshmërinë dhe me realitetin familjar e njerëzor në çdo gjendje dhe kjo vërehet shumë qartë duke e krahasuar atë me çfarëdo ligji tjetër që njih njerëzimi që nga injoranca e hershme e deri tek ajo e tashme. Është ligj i cili mbron përbërjen familjare njerëzore qoftë edhe për një person dhe nuk i privon gratë e as

[2] Përmasa për të cilat do të ketë sqarime më vonë inshaAllah (sh.p.).

[3] Transmeton Ibën Xheriri në tefsirin e tij 8/32.

të vegjlit nga trashëgimia për shkak se janë femra apo të vegjël.

Kështu që Allahu i dha të drejtën e trashëgimisë secilit që e meriton atë, saqë dhe i quajti këto të drejta: "*(Ky përcaktim është) Urdhër nga Allahu.*" Nisa: 11

Në ajetin vijues: "*(Ky përcaktim është) Porosia e Allahut.*" Nisa: 12

E pas këtyre të drejtave vijon kujdesi i veçantë dhe ndëshkimi i rreptë për ata që e kundërshtojnë ligjin e Allahut në trashëgimi. Allahu i Lartësuar thotë: "*Këta janë kufijtë e caktuar nga Allahu, e kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai do ta shpjerë atë në xhennete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe në to do të qëndrojnë përgjithmonë. E, ky është shpëtim i madh. E, kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe shkel dispozitat e Tij, atë e shtie në zjarr të përjetshëm e për të ka ndëshkim poshtëruës.*" Nisa: 13-14^[4]

Veçoritë e ligjit islam në trashëgimi

Veçoritë e ligjit islam në trashëgimi janë si veçoritë e tij në të gjitha legjislacionet e qarta si qartësia e diellit në mes të ditës. Ligji islam është ai që i dha secilit të drejtën siç e meriton, siç aludon hadithi: "*Me të vërtetë se Allahu i dha çdokujt hakun që meriton, andaj nuk ka testament për trashëguesin.*"^[5]

Përderisa koha e injorancës u dha të drejtën e trashëgimisë të fortëve dhe i privoi të dobëtit, Islami ua dha të drejtën të dobëtëve sepse edhe këta meritojnë mëshirë e ndihmë ashtu siç ka ardhur në hadith: "*Sikur t'i lësh trashëgimtarët e tu të*

pasur është më mirë sesa t'i lësh të varfër, t'u shtrijnë dorën njerëzve."^[6] Islami nuk i privoi të fortët nga trashëgimia, saqë çdokush që i plotëson kriteret e trashëgimisë e nuk ka ndonjë pengesë për të, ai është trashëgimtar, qoftë i madh apo i vogël, mashkull apo femër, i fortë apo i dobët. Nëse koha e injorancës merr parasysh për trashëgimtarin vetëm anët dobiprurëse, saqë nuk trashëgon përveçse ai i cili shalon kalin (d.m.th. luftëtari), merr plaçkë lufte apo preokupohet për nderin familjar, prandaj dobia nuk është e veçantë për këta persona, porse ka mundësi që dikush tjetër të jetë më dobiprurës për të vdekurin se këta persona, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar: "*Ju nuk dini se kush është më afër dobisë suaj, prindërit tuaj ose fëmijët tuaj.*"

Nisa: 11
S'ka dyshim se ligji islam është ligj i drejtësisë, i barazisë, i mëshirës, siç thotë Allahu i Lartësuar: "*Atij nuk mund t'i mvishet e pavërteta nga asnjë anë, është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit.*" Fussilet: 42

Islami përforcon parimet e trashëgimisë për të drejtën e të afërmve
Islam e ka përforcuar këtë parim për të drejtën e të afërmve mes trashëgimtarit e trashëguesit dhe e përsosi këtë parim mes tyre me lidhje familjare, siç ka thënë Allahu i Lartësuar: "*...por farefisi (lidhjet familjare) sipas Librit të Allahut janë më të afërt për njëri-tjetrin...*" Enfal: 75. Ky parim i jep përparësi trashëgimi pasardhësit para paraardhësve e para të afërmve të tjerë e megjithëkëtë nuk i privon (ndalon) nga trashëgimia paraardhësit e as të afërmit e tjerë, përkundrazi, caktoi për

[4] El-Vexhiz fi fikhi es-Sunneti vel Kitabil Aziz (fq. 416).

[5] Transmetojnë të pestët përveç Ebu Davudit, e Tirmidhiu e saktësoi 6/43.

[6] Transmeton grupi, "Nejlul Evtar" 6/40-41.

çdonjërin përmasë të veçantë. Me këtë qetësohet ai që ka dhënë mundin e tij për të lënë pas vetes për pasardhësit atë që nuk i privon ata nga trashëgimia pas vdekjes së tij, gjë kjo e cila nxit të mundohet edhe më tepër. Në këtë kuptim aludon fjala e Allahut të Lartësuar: *"Allahu ju urdhëron për (çështje të trashëgimisë) fëmijët tuaj..." e deri te fundi i ajetit: "Ju nuk dini se kush është më afër dobisë suaj prindërit tuaj ose fëmijët tuaj."* Nisa: 11

Gjithashtu fjala e Allahut: *"Meshkujve u takon pjesë nga pasuria që e lënë prindërit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave u takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit..."* Nisa: 7

Po ashtu edhe fjala e Allahut: *"...por farefisi (lidhjet familjare) sipas librit të Allahut janë më të afërt për njëri-tjetrin..."* Enfal: 75

Edhe thënia e Resulullahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem: *"Shpërndajuni trashëgiminë atyre që e meritojnë dhe atë që tepron, atëherë ajo është për mashkullin më të afërt."*^[7]

Respektimi i pasurisë individuale në Islam

Në parimet e trashëgimisë në Islam gjejmë argumente të qarta për respektimin e pasurisë individuale, saqë gjithçka që lë i vdekuri shkon në duart e pasardhësve të tij me një respektim të veçantë dhe këtë e aludon edhe fjala e Resulullahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem: *"Kush lë pasuri, ajo është për pasardhësit e tij."* Transmeton^[8]

Sqarimi i urtësisë në përcaktimin e përmasave të trashëgimisë

Allahu i Lartësuar është i Urti, i Gjithëdituri, saqë nuk obligon me diçka përveçse për një urtësi madhështore sepse Ai është i pastër dhe larg nga kotësia dhe për këtë e cilësoi Vetën me dituri e urtësi të përsosur. Shpeshherë ndodh që në përmendjen e dispozitës të aludojë në urtësinë e saj e nga këto dispozita janë edhe dispozitat e përmasave të trashëgimisë si në ajetin: *"Allahu ju urdhëron për (çështje të trashëgimisë) fëmijët tuaj..." e përfundon me fjalën: "Vërtet Allahu është i Gjithëdituri, i Urti."* Nisa: 11. Kjo në mënyrë që ta ndiejnë zemrat e njerëzve caktimin e Allahut, edhe pse kjo është origjina prej së cilës nuk u lejohet atyre ndonjë gjykim tjetër dhe kjo është dobia e ndërtuar mbi diturinë dhe urtësinë e përsosur të Allahut. Allahu gjykon sepse Ai është i Gjithëdituri e njerëzit nuk dinë, gjithashtu Ai obligon sepse Ai është i Urti e njerëzit pasojnë epshet.

Islami dha si legjislacion për trashëgiminë një ligj të drejtë e të matur, që aprovon posedimin e pasurisë së tundshme dhe të patundshme të njeriut dhe bartjen e pasurisë pas vdekjes tek pasardhësit e tij dhe shpërndarjen e saj tek ata që e meritojnë, pa i munguar e pa i shtuar askujt asgjë, duke sqaruar renditjen në të drejtat që kanë të bëjnë me pasurinë e lënë pas vdekjes së njeriut, kushtet, shkaqet, pengesat e trashëgimisë dhe përmasën sa i takon çdo trashëgimtari, ashtu siç sqaron ky ligj kush trashëgon e kush jo. Gjithashtu jepen dispozitat që kanë të bëjnë me trashëgimtarët, saqë ky ligj nuk la gjë pa sqaruar qartë dhe plotësisht sa i përket bartjes së pasurisë dhe

[7] Transmeton Buhariu nr. 4315 dhe Muslimi nr. 1776

[8] Buhariu - shih në Fet'hul-Bari 9/12

zotërimin të saj nga i trashëguari tek trashëguesi, duke i aprovuar të drejtat dhe duke i mbyllur të gjitha rrugët dhe shkaqet e rrëmbimit të pasurisë së njerëzve apo duke i mbyllur shtigjet e mospajtimeve në përcaktimet e trashëgimtarëve. Tërë këtë Allahu e sqaroi në formën më të shkëlqyer dhe falënderimi i takon Allahut fillim e mbarim.

Ndodh që disa njerëz të pyesin për urtësinë e dallimit-favorizimit mes mashkullit dhe femrës në trashëgimi.^[9]

Përgjigja e saj është se mashkulli është më nevojtar për pasuri sesa femra, sepse burrat përkujdesen për gratë. Mashkulli është më dobiprurës për të vdekurin sa ishte gjallë sesa femra, saqë Allahu i Lartësuar sinjalizoi me këtë në ajetin: *"Ju nuk dini se kush është më afër dobisë suaj, prindërit tuaj apo fëmijët tuaj."* Nisa: 11

Përderisa mashkulli është më dobiprurës dhe më nevojtar, i takon që të ketë edhe pjesë më të madhe se femra. Nëse thuhet se një gjë e tillë nuk qëndron njësoj me fëmijët e nënës^[10], themi se përkundrazi, ata janë të barabartë, meshkujt dhe femrat, sepse ata trashëgojnë me anë të nënës dhe kjo është vetëm afërsi femërore dhe për këtë arsye ata janë të barabartë në trashëgimi dhe nuk dallojnë meshkujt prej femrave tek ata.

Mashkulli gjithmonë dallohet, favorizohet nga femra në trashëgimi nëse janë me pozitë^[11] të njëjtë për shkak të veçimit të mashkullit për përkujdesjen familjare dhe për bartjen e përgjegjësisë në ruajtjen e nderit dhe sepse mashkulli ka shpenzime më të

shumta, ndryshe nga femra, e cila është nën përkujdesjen e babait, burrit ose birit të saj. Këtu nuk është çështja për dallimin e një gjinie ndaj tjetrës, por është çështje drejtpeshimi e drejtësisë në raport me atë që është mbi supet e meshkujve dhe atë që është mbi supet e femrave në përbërjen familjare dhe në rregullat shoqërore islame, në mënyrë që të dalë në shesh drejtësia. Allahu e ka treguar urtësinë e dallimit, favorizimit të mashkullit ndaj femrës në trashëgimi kur thotë: *"Meshkujt udhëheqin (dhe përkujdesen) për gratë, ngase Allahu ka graduar disa mbi të tjerët dhe për shkak se ata shpenzojnë pasurinë e tyre."* Nisa: 34, Sepse ai i cili varet nga dikush që shpenzon për të (në këtë rast gruaja e cila varet nga burri, i cili shpenzon për të), gjithmonë është në pakësim, kurse i varuri që shpenzohet për të (gruaja) gjithmonë është në shtim, e prej urtësisë është t'i jepet përparësia atij që është në pakësim ndaj atij që është në shtim.

Allahu e di më së miri.

Vijon ...

Kjo hyrje kryesisht është përgatitur nga libri "Et-tahkikat el-merdiye fi mebahith el-faradiye" të shejh Salih ibën Fevzan el-Fevzan, botimi i tretë nga "Mek-tebul Mea'rif" Rijad dhe libri "El-Vexhiz fi fikhi es-Sunneti vel Kitabil Aziz" të shejh Abdul-Adhim Bedevi el-Halefi, botimi i tretë nga "Dar ibën Rex-heb", Egjipt.

*Përmbledhi dhe përshtati:
Namik Vehapi*

[9] Për shkak se mashkullit i takon aq sa u takon dy femrave.

[10] Nëse i vdekuri nuk ka prindër e as fëmijë (djem-vajza), por ka vetëm vëllezër dhe motra nga nëna, në këtë rast këta llogariten si fëmijët e nënës, kështu që nëse janë dy vetë a më shumë pa marrë parasysh a janë një mashkull e një femër apo dy meshkuj e një femër apo e kundërta. Të gjithë janë të barabartë në një të tretën e pasurisë së lënë nga i vdekuri (sh.p).

[11] Nuk është qëllimi këtu me pozitë të njëjtë intelektuale apo institucionale, por me pozitë të njëjtë si p.sh. që të dy (mashkulli, femra) rrjedhin nga një baba e një nënë.

KËSHILLË PËR TË RINJTË SELEFI (I)

Prandaj, nxënësit e dijes duhet të bëjnë kujdes në dallimin mes këtyre dy çështjeve, sepse ka prej njerëzve që mendojnë se mirësjellja dhe butësia me njerëzit janë dobësi në fe dhe servilizëm, ndërkohë që një grup tjetër e konsideron butësinë me njerëzit si pranim të gabimeve të tyre apo si heshtje ndaj të kotës.

PARATHËNIE

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve. Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin tonë Muhamed, mbi familjen dhe shokët e tij.

Këtë këshillë ua drejtoj të rinjve muslimanë të Ehli Sunnetit, duke kontribuar kështu në orientimin e muslimanëve dhe në përmirësimin e Ehli Sunnetit, pasi ekzistojnë argumente të shumta që nxisin për këtë.

Shtysë për këtë këshillë është përçarja e thellë në të cilën jetojnë të rinjtë selefi në shumë prej vendeve islame, madje edhe në vende joislame

ku jetojnë pakica muslimanësh. Shkak për këtë përçarje është kundërshtimi në disa çështje ideologjike dhe qëndrime praktike kundrejt disa kundërshtarëve dhe çfarë rrjedh prej kësaj, si largimi e bojkoti, madje edhe armiqësimi dhe urrejtja mes Ehli Sunnetit, saqë fitnet dhe rreziku i tyre kanë marrë përmasa të mëdha. Kjo gjë ka ndikuar në vazhden e davetit për në Sunnet, madje shumë njerëz i ka penguar që ta përqafojnë atë pasi njerëzit kishin filluar të drejtoheshin drejt saj në shumë prej viseve dhe vendeve.

Këtë këshillë do ta përmbledh në disa pika. I lutem Allahut të Lartësuar që të më bëjë risk

në të sinqeritetin në qëllim dhe saktësinë në fjalë e t'i bëjë dobi kujtdo që e lexon atë prej muslimanëve.

1 Prej bazave themelore në fe është se muslimani ka detyrë të ndreqë vetveten dhe të përpiqet ta shpëtojë atë e të largohet prej shkaqeve që e shkatërrojnë, para se të merret me të tjerët.

Allahu i Lartësuar thotë: *“Pasha kohën!*

Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.”^[1]

Në këtë sure Allahu i Lartësuar na tregon për ata të cilët kanë shpëtuar prej humbjes dhe shkatërrimit, që i kanë vërtetuar dhe përmëshur këto cilësi. Ata kanë përmëshur besimin dhe punën e mirë në veten e tyre, para se të thërrisnin të tjerët dhe t'i këshillonin ata për të vërtetën dhe durimin. Kështu është përcaktuar kjo çështje.

Allahu i Madhëruar i ka kritikuar Beni Israilët për kundërshtimin që i bënë kësaj baze duke thënë: *“A po i urdhëroni (thirrni) njerëzit për punë të mira, e veten tuaj po e harroni? Ndërsa ju e lexoni librin (Tevratin). A nuk po mendoni?”*^[2]

Prandaj është detyrë për të rinjtë që të preokupohen me rregullimin e vetvetes para se të preokupohen me të tjerët. Kur ata ta përmëshin këtë bazë, duke bashkuar zbatimin e fesë së Allahut në vetvete dhe thirrjes së të tjerëve në të, atëherë me të vërtetë do të jenë në rrugën e selefëve. Pas kësaj Allahu do të sjellë dobi nëpërmjet tyre dhe ata do të jenë thirrës në Sunnet me fjalët dhe veprat e tyre. Beto hem në Allahun se kjo është prej gradave më të larta, që nëse dikush do të udhëzohet në të, do të jetë prej robërve të zgjedhur të Allahut në Ditën e Gjykimit.

[1] Asr.

[2] Bekare: 44.

[3] Fusiler: 33.

Allahu i Lartësuar thotë: *“E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: “Unë jam prej muslimanëve?”*^[3]

2 Duhet ditur se Ehli Sunneti me të drejtë janë ata që e zbatojnë plotësisht Islamin, si në besim ashtu edhe në sjellje

Prej kuptimit të mangët është të mendohet se suni apo selefi është ai që vërteton akiden e Ehli Sunnetit pa i kushtuar vëmendje aspektit të sjelljes dhe moralit islam dhe të drejtave reciproke mes muslimanëve.

Shejhul Islam Ibnu Tejmije në fund të Akides Uasitije, pasi përmend parimet e Ehli Sunnetit në besim: “Veç asaj që përmendëm prej bazave, ata (Ehli Sunneti) urdhërojnë për mirë dhe ndalojnë nga e keqja ashtu siç e obligon sheriati.

Ata besojnë në kryerjen e haxhit, xhihadit, xhumave dhe bajrameve bashkë me prijësit, sido qofshin ata, të devotshëm apo të degraduar.

Ata (Ehli Sunneti) bëjnë kujdes për kryerjen e namazit me xhemat dhe e konsiderojnë pjesë të fesë këshillën ndaj ummetit.

Ata besojnë në kuptimin e fjalës së Profetit, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të: *“Besimtari për besimtarin janë si një ndërtesë e lidhur fort, që një pjesë e saj shtrëngon tjetrën”* dhe ndërthuri gishtat e tij. Dhe në fjalën e tij *“Shembulli i besimtarëve në dashurinë, mëshirën dhe afrimitetin mes tyre, është si shembulli i një trupi që kur një gjymtyrë apo organ i tij nuk është mirë, atëherë i gjithë trupi ndikohet dhe kalon në temperaturë dhe pagjumësi.”*

Ata (Ehli Sunneti) urdhërojnë për durim në fatkeqësi, për falënderim në bollëk dhe për kënaqjen me caktimin e hidhur.

Ata thërrasin për morale të larta dhe vepra të hijshme, besojnë në kuptimin e fjalës së Profetit, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin

mbi të: *“Besimtari me besim më të plotë është ai që është më i moralshëm.”*

Ata nxisin që të rregullosh lidhjet me atë që t’i ka prerë, t’i japësh atij që nuk të jep dhe të falësh atë që të ka bërë zullum. Urdhërojnë për nderimin e prindërve, për forcimin e marrëdhënieve farefisnore dhe për fqinjësi të mbarë. Ata ndalojnë nga mburrja, nga mendjemadhësia, nga padrejtësia dhe teprimi ndaj krijsave, me të drejtë apo pa të drejtë. Urdhërojnë për përsosmërinë e moralit dhe ndalojnë nga sjelljet e ulëta.

Në gjithçka që ata thonë dhe bëjnë, prej këtyre që përmendëm apo të tjerave, ata janë pasues të Kur’anit dhe Sunnetit dhe rruga e tyre është feja islame, me të cilën Allahu i Madhëruar dërgoi Muhamedin, sal-lAllahu alejhi ve sellem.

3 Prej qëllimeve madhështore për të cilat nxit Islami është “udhëzimi i njerëzve në këtë fe”. Profeti, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, i ka thënë Aliut, Allahu qoftë i kënaqur me të: *“Nëse Allahu me ty udhëzoi një njeri të vetëm është më mirë për ty sesa devetë e kuqe.”*^[4]

Prandaj bëhet detyrë për këdo që Allahu i ka dhënë mirësi dhe e ka udhëzuar në Sunnet, që të preokupohet me thirrjen e atyre që nuk e njohin atë (Sunnetin) apo që janë të mangët në të. Duhet të shfrytëzohen të gjitha metodat e mundshme për udhëzimin e njerëzve, për afrimin dhe zbutjen e zemrave të tyre për të pranuar të vërtetën. Kjo bëhet duke iu drejtuar atyre me butësi, ashtu siç Allahu i Madhëruar i ka thënë Musait dhe Harunit, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi ta: *“Shkoni që të dy te faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Atij i thoni fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet.”*^[5]

[4] Buhari dhe Muslimi. Devetë e kuqe ishin pasuria më e shtrenjtë për arabët.

[5] Ta Ha: 43-44.

[6] Ahkaf: 35.

[7] Kalem: 9.

[8] Tefsiri i Begaviut 4/377.

Allahu i Lartësuar na ka treguar se si Faraoni e kishte tejkaluar kufirin, madje Allahu e dinte për të se ai do të vdiste si mohues e megjithatë Ai urdhëroi që atij t’i flitej me butësi. Çfarë mund të thuhet pas kësaj për gabimtarët muslimanë, si duhet të sillemi me ta?

Me njerëzit që thërret mund të përdorësh edhe tituj që përshtaten me pozitën e tyre. Profeti, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, i ka shkruar Heraklit duke i thënë *“Drejtuar Heraklit, të madhit të romakëve”*. Madje me kreun e munafikëve, Abdullah bin Ubej bin Selul, përdorte epitetin “Ebul Habab”.

Gjithashtu të kihet parasysh durimi në rastet e sjelljes së keqe që shfaqet nga disa prej atyre që do të ftosh në fe. Duhet t’i presësh me butësi dhe të mos nxitohesh për t’iu përgjigjur atyre. I Lartësuari thotë: *“Ti (Muhamed) duro, ashtu sikurse duruan të Dërguarit e vendosur dhe mos kërko ngutjen e dënimit për ta.”*^[6]

4 Kërkuesit e dijesh, sidomos thirrësit, duhet të bëjnë dallim mes mirësjelljes e butësisë me njerëzit dhe lajkave e servilizmit. Mirësjellja dhe butësia janë të kërkuara dhe lidhen me suksesin në marrëdhënie me ta. Në librin “Lisanul arab” thuhet: “Mirësjellja me njerëzit: butësia, afrimiteti dhe durimi në shoqëri, në mënyrë që të mos largohen prej teje”.

Ndërsa servilizmi është i nënçmuar dhe ndikon negativisht në fe. Allahu i Lartësuar thotë: *“Ata dëshirojnë që ti të bësh lëshime, kështu që dhe ata të bëjnë lëshime.”*^[7] Hasen el Basri për kuptimin e ajetit ka thënë: “Ata dëshirojnë që ti të lëshosh pe nga feja jote që edhe ata të lëshojnë pe nga e tyre.”^[8]

Muslimani me moral është i butë në marrëdhënie pa lëshuar pe nga feja e vet. Ndërsa servili u afrohet njerëzve duke bërë lëshime në anën e fesë.

Profeti, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ishte më i moralshmi në mesin e njerëzve dhe më i buti me ummetin. Kjo tregon anën e butësisë dhe mëshirës në davetin e tij. Gjithashtu ai ka qenë më i përpikti në fenë e Allahut dhe nuk i lëshonte pe askujt, kushdo që të ishte ai. Kjo tregon anën e seriozitetit në fe, gjë që nuk përputhet me servilizmin.

Prandaj, nxënësit e dijes duhet të bëjnë kujdes në dallimin mes këtyre dy çështjeve, sepse ka prej njerëzve që mendojnë se mirësjellja dhe butësia me njerëzit janë dobësi në fe dhe servilizëm, ndërkohë që një grup tjetër e konsideron butësinë me njerëzit si pranim të gabimeve të tyre apo si heshtje ndaj të kotës. Secili prej këtyre mendimeve është i gabuar dhe larg së vërtetës. Prandaj le të jemi të vëmendshëm për këtë, sepse është një çështje delikate që nuk e kupton vetëm se ai të cilin Allahu e ruan dhe e udhëzon.

5 Thirrësi në rrugën e davetit përdor dy mënyra, për të cilat kanë orientuar argumentet:

- Mënyra e butësisë dhe e nxitjes
- Mënyra e kritikës dhe e bojkotit

Gabojnë ata që përdorin vetëm një mënyrë me këdo. Duhet përdorur me secilin kundërshtar mënyra që është më efikase për të, që ai ta pranojë të vërtetën dhe të kthehet në rrugën e drejtë. Nëse butësia është më e dobishme me kundërshtarin dhe më shpresëdhënëse për udhëzimin e tij, atëherë vetëm ajo lejohet të përdoret me të. Nëse është bojkoti ai që ndikon për mirë, atëherë ai është i lejuari. Prandaj kush përdor mënyrën e butësisë me ata që meritojnë bojkotin, i tilli është i pakujdesshëm dhe neglizhent. Ndërsa kush përdor mënyrën e bojkotit me ata që meritojnë butësi, nuk është tjetër veçse denigrues dhe ekstremist. Shejhul Islam Ibnu Tejmije thotë: “Bojkoti ndryshon në varësi të bojkotuesve, a janë ata të fortë apo të dobët, të paktë apo të shumtë.

Qëllimi i tij është kritika e të bojkotuarit dhe edukimi i tij si dhe tërheqja e vëmendjes njerëzve të tjerë, që të mos bien në të njëjtin gabim. Nëse në të ka dobi të dukshme, pasi bojkoti ka çuar në dobësimin e së keqes dhe zhdukjen e saj, atëherë ai është i lejuar. Por nëse as i bojkotuari dhe as të tjerët nuk kanë dobi prej tij, për shkak se bojkotuesi është i dobët, por edhe sepse shtohet e keqja dhe dëmi është më i madh se dobia, atëherë nuk lejohet bojkoti. Prandaj me disa njerëz butësia është më e dobishme sesa bojkoti, ndërsa me disa të tjerë bojkoti është më i dobishëm sesa butësia. Për këtë arsye Profeti, paqja dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, me disa njerëz sillej butë dhe i afronte, ndërsa me disa të tjerë ishte i ashpër dhe i bojkotonte. Ashtu si me armikun, që nganjëherë kundrejt tyre lejohet lufta, nganjëherë paqja apo marrëveshja dhe nganjëherë marrja e xhizjes, në varësi të gjendjes dhe dobisë. Edhe dijetarët si imam Ahmedi etj., në këtë çështje përgjigjen sipas këtij rregulli.”^[9]

Duke sqaruar gabimin që bëhet kur përgjithësohet njëra prej dy mënyrave, bojkoti apo butësia, pa e marrë parasysh rregullin e mëparshëm, imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Disa njerëz e zgjedhën bojkotin dhe kritikën si mënyrë të tyre dhe e përdorën atë në çështje që nuk ishin urdhëruar për to, e bojkoti nuk ishte as detyrë e as i pëlqyer. Madje për shkak të bojkotit ata lanë çfarë kishin vaxhib dhe sunnet dhe ranë në haram. Ndërsa disa të tjerë hoqën dorë tërësisht nga bojkoti, derisa braktisën atë që ishin urdhëruar të bojkotonin prej të këqijave të shpikura.”^[10]
Vijon....

*Dr. Ibrahim ibën Amër er Ruhañli
Përshtati: Mirandi Shehaj*

[9] Mexhmuul Fetava 28/206.

[10] Mexhmuul Fetava 28/21.



Këto hadithe argumentojnë qartë se muslimanit i lejohet vizita e varreve të jobesimtarëve, në veçanti vizita e varrit të të afërmit, dhe se qëllimi i vizitës së varreve të jobesimtarëve është mësimi dhe këshilla.

Medh'hebi shafij^[2], hanbelij^[3] dhe dhahirij^[4] mendojnë se i lejohet muslimanit vizita e varrezave të jobesimtarëve me qëllim të vetëkëshillimit dhe marrjes së mësimit prej tyre.

Për këtë mendim argumentimi është si

vijon:

1. Hadithi nga Ebu Hurejra Allahu qoftë i kënaqur me të, që thotë: *"Përgjamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e vizitoi varrin e nënës së tij dhe qau dhe i bëri të tjerët përreth tij të qajnë, pastaj tha: "Kërkova nga Zoti im të më lejojë të*

[1] Nga faqja 311-315, botoi Daru Ibnul Xhevzj sh.p.

[2] Shiko "El Mexhmu" 5/120, "Mugnijul Muhtaxh" 2/57, "Hashijetul Xhumel" 2/209. Është cituar nga Subkij se ai e ka lejuar vizitën e varrezave përgjithësisht, qofshin ato varrezat e muslimanëve apo të jobesimtarëve. Nëse vizita bëhet me qëllim për të marrë mësim dhe për të kujtuar vdekjen (Havashij Esh-Shervanij dhe Ibn Kasim el Abadij 3/200).

[3] Shiko El Furuw 2/299, El Insaf 2/562 dhe Kishaful Kanai 2/250.

[4] Shiko El Muhal-la 5/160.

kërkoj falje për nënën, por nuk m'u lejua. I kërkova që të më lejohë vizitën e varrit të saj dhe kjo m'u lejua, prandaj vizitoni varrezat se vërtet ato ju përkujtojnë vdekjen."^[5]

2. Hadithi nga Burejdeh Allahu qoftë i kënaqur me të, që thotë: "Ishim me të Dërguarin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem rreth një mijë kalorës. Zbritëm bashkë me të dhe i falëm dy rekate. Pastaj ai u drejtua me fytyrë nga ne dhe nga sytë e tij rridhnin lot. U ngrit Umeri duke i thënë: "Babai dhe nëna ime të qofshin fli për ty! Ç'ka ndodhur me ty o i Dërguari i Allahut?" Iu përgjigj: "I kërkova leje Zotit tim që të kërkoj falje për nënën time, por nuk më lejoi dhe sytë e mi lotuan prej mëshirës për të. Dhe i kërkova Zotit tim që ta vizitoj varrin e saj dhe këtë ma lejoi. Unë më herët jua pata ndaluar vizitën e varrezave, andaj vizitojini tani që t'ju shtohen të mirat nga vizitat e tyre."^[6]

Këto hadithe argumentojnë qartë se muslimanit i lejohet vizita e varreve të jobesimtarëve, në veçanti vizita e varrit të të afërmit, dhe se qëllimi i vizitës së

varreve të jobesimtarëve është mësimi dhe këshilla. Kjo arrihet me vështrimin e varreve të tyre. Varri i të afërmit ka ndikim edhe më të fortë në këshillim dhe përkujtim (ndaj vizituesit sh.p). Për këtë arsye, El Kadi Ijadi^[7] thotë: "Vizita që i bëri Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem varrit të nënës së tij kishte për qëllim forcimin e këshillës dhe përkujtimit duke e vështruar varrin e saj dhe për këtë aludon fjala e tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në pjesën e fundit të hadithit: "Vizitoni varrezat se ato vërtet jua përkujtojnë vdekjen."^[8]

Këtë mendim e kundërshton El Mave-rdij nga radhët e shafijve, pasi thotë se është haram për muslimanin vizita e varrit të jobesimtarit^[9], duke e argumentuar këtë me fjalën e Allahut subhanehu ve te ala: "Dhe asnjërit prej tyre kur të vdesin mos ia fal namazin (e xhenazes) kurrë, e as mos qëndro pranë varrit të tij (që të lutesh apo të kërkosh falje për të)[10]..." Tevbe: 84 ^[11]

Këtij argumentimi me këtë ajet i përgjigjemi se qëllimi i ajetit në të cilin theksohet të qëndruarit pranë varrit të

[5] Transmeton Muslimi në "El Xhenaiz" në kapitullin Isti'dhanun-Nebij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem rabbehu az-zevehel fi zijareti kabri ummihi 2/671 numër 976, Ebu Davudi në El Xhenaiz në kapitullin Zijaretul Kubur 3/215, numër 3234, Nesaiu në "El Xhenaiz" në kapitullin Zijaretu kabril mushrik/4/395, numër 2033, dhe Ibn Maxhe në "El Xhenaiz" kapitulli Ma xhae fi zijareti kuburil mushrikin 1/501, numër 1572. E ka transmetuar këtë hadith në version të shkurtuar në kapitullin Ma xhae fi zijaretil Kubur 1/500, numër 1569.

[6] Transmeton Ahmedi 5/355, 357, 359, Ibn Ebi Shejbeh në "El Xhenaiz", kapitulli Men Rehase bi zijartil Kubur 3/224, Hakimi dhe teksti i hadithit është nga ai, në librin "El Xhenaiz" 1/532, numër 1391, Ibn Hibbani në "El Eshribeh faslun fil Eshribeh" 11/212, numër 5390, Bejhekiu në "El Xhenaiz", kapitulli Zijaretul Kubur 4/128, numër 7193. Hakimi thotë për këtë hadith: "Ky hadith është sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, por nuk e kanë transmetuar". Me këtë është pajtuar Dhehebiu 1/532. Ndërsa Hejthemi thotë: "Personat në sened janë besnikë (shiko "Muxhmauz-zevaid" 1/121,122). Hadithi është theksuar pa u përmendur ngjarja e nënës së Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në faqen 261 dhe kjo gjendet tek Muslimi dhe tek të tjerët, duke u përmendur vetëm lejimi për vizitë.

[7] Ky është Ebul Fadël Ijadi ibn Musa ibn Ijad ibn Amër El Jahsabij El Endelusij, pastaj Sebti El Malikij el-Imamul Al-lame el-Hafidhul Evhad dhe Shejhulislam. Ka shkruar dhe tubuar shkrime. Me shkrimet e tij ua kaloi të tjerëve dhe emri i tij u bë i njohur në të gjitha anët. Nga shkrimet e tij veçojmë: Esh-Shifa bi Tarifit Hukukil Mustafa, Mesharikul Envar, në "Garibul hadith", shkroi Ikmalul Mualim bi Sherh Sahihi Muslim. Ka vdekur më 544 sipas kalendarit hixhri në Merakish (shiko "Sieru Ealamin-Nubela" 20/212 dhe "Ed-Dejbaxhul Medh'heb" 2/56).

[8] Shiko në "Sherh Sahih Muslim" nga Neveviu 7/45.

[9] Shiko në "Elhavi El Kebir" 3/19.

[10] Përkthimi i këtij ajeti është marrë nga Sherif Ahmeti, por në mes kllapave në përkthim qëndron "për lutje e vizitë" dhe e drejtë është që të mbetet ashtu siç e kemi shënuar dhe këtë e sqaron edhe autori i kësaj teme (sh.p).

[11] "Elhavi El Kebir" 3/19

jobesimtarit është lutja për të vdekurin dhe kërkimi i faljes për të^[12], e kjo është e ndaluar me këtë ajet dhe me ajete të tjera, si për shembull fjala e Allahut subhanehu ve te ala: *"Nuk i takon Pejgamberit e as atyre që besuan që të kërkojnë falje për idhujtarët edhe nëse këta janë nga të afërmit e tyre..."* Tevbe: 113

Gjithashtu, edhe hadithet e lartpërmendura që tregojnë rastin e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kur kërkoi leje nga Zoti i tij që të kërkojë falje për nënën e tij, e kjo nuk iu lejua, e sqarojnë këtë, dhe ajo që e sqaron edhe me qartë këtë është se ajeti ka zbritur për çështjen e Abdullah ibn Ubej ibn Selulit^[13] dhe për namazin e xhenazes që ia fali Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem atij^[14]. Andaj në ajet nuk kuptohet ndalesa ndaj vizitës së varrit të jobesimtarit dhe për këtë nuk është i drejtë argumentimi me këtë ajet për të ndaluar vizitën e varreve të jobesimtarëve. Gjithashtu ky ajet nuk është në kundërshtim me hadithet që argumentojnë lejimin e vizitës së varreve të jobesimtarëve.

Fukahatë e shafijve^[15] dhe hanbelijve^[16] theksojnë gjithashtu se nuk lejohet

gjatë vizitës në varrezat e jobesimtarëve që të përshëndeten me selam e as të kërkohet falje për ta. Madje hanbelijtë thonë se vizituesi i varrezave të jobesimtarëve duhet t'i përgëzojë ata me zjarr. Këtë e argumenton hadithi i Saed ibn Ebi Vekasit radijAllahu anhu, që thotë: *"Erdhi një beduin te Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe i tha: "Vërtet babai im ishte, që mbante lidhje të mira me të afërmit dhe ishte... (dhe i përmendi të mirat e tij sh.p.), pra ku është ai?"* Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem iu përgjigj: *"Ai është në zjarr". Nga kjo beduini u ndie keq dhe tha: "O i Dërguari i Allahut, e babai yt ku është?"* Iu përgjigj: *"Kur të kalosh afër varrit të jobesimtarit, përgëzoje atë me zjarr."* Tha (Saedi): *"Beduini e pranoi Islamit dhe tha: "Më ka obliguar me këtë obligim i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe nuk kam kaluar afër varrit të ndonjë jobesimtari përveç se e kam përgëzuar atë me xhehennem"*^[17].

Këtë hadith e vërteton edhe hadithi nga Ebu Hurejra radijAllahu anhu, që transmeton prej Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem të ketë thënë: *"Nëse kaloni afër varrezave tona dhe*

[12] Shiko "El Furuë" 2/199, "Kishaful Kanai" 2/150 dhe ky është mendimi i shumicës së komentatorëve të Kur'anit (shiko El Xhamiu li Ahkamul Kur'an 8/223).

[13] Ky ishte nga udhëheqësit e mynafikëve, hipokritëve (sh.p.).

[14] Kurtubiu thotë: "Kjo ngjarje është vërtetuar në "Sahihun" e Buhariut dhe Muslimit dhe janë të ekspozuara transmetimet se Pejgamberi sa-lAllahu alejhi ve sel-lem ia ka falur namazin e xhenazes këtij munafiku dhe ajeti ka zbritur pas kësaj ngjarjeje (shiko "El Xhamiu li Ahkamul Kur'an" 8/218).

[15] Shiko "Nihajetul Muhtaxh" 3/37.

[16] Shiko "Mexhmual Fetava" 27/165, "Ihtijarat" (90) dhe "Kishaful Kanai" 2/150.

[17] Transmeton Tabaranij në "el-Kebir" 1/145, numër 326, dhe Bezzari në "Musnedin" e tij ("El Bahruz-Zihar") 3/299, numër 1089. Hejthemiu thotë: "Personat në sened janë besnikë ("Muxhmeuz-Zevaid" 1/122, 123). Gjithashtu e transmeton Ibn Maxhe prej hadithit të Ibn Umerit radijAllahu anhuma në "El Xhenaizu", kapitulli Ma Xhae fi Zijareti Kuburil Mushrikin 1/501. numër 1573, dhe në "Zevaid" (senedi i tij është sahih me persona të besueshëm). Albani thotë: "Hadithi është prej musnedit të Sad ibn Ebi Vekasit radijAllahu anhu dhe theksimi i tij "nga Ibn Umeri" është gabim prej ndonjë transmetuesi (prej personave në sened). Shiko "Silsiletul Ehadithus-Sahihah" 1/55, numër 18.

tuaja që janë nga koha parakur'anore (ehllul xhahilije), tregojuni se vërtet janë në zjarr.”^[18]

Ebu Hatimi^[19] thotë: “Urdhri i Mustafait sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në ngjarjen e këtij muslimani është që kur të kalojë afër ndonjë varri të jomuslimanit, ta falënderojë Allahun xhele ve ala për udhëzimin e tij në Islam. Kjo kuptohet nga teksti i urdhrit që e lajmëron të vdekurin se ai është në zjarr.”^[20]

Pra, siç është e ndaluar për muslimanin që nëse viziton varrezat e jobsimtarëve, t'i përshëndesë me selam ose të kërkojë falje për ta, duke u argumentuar me hadithet e lart-

përmendura, gjithashtu nuk i lejohet muslimanit që vizitën e varrezave të jobsimtarëve ta realizojë me qëllim që t'i madhërojë ata me nderime apo me qëllim admirimi për ta dhe ngritje të tyre. Veçanërisht këto të kihen parasysh tek ato varre për të cilat thonë se janë të personave që ishin nga paria e lartë, për arsye se kjo gjë është nga llojet e miqësisimit të jobsimtarëve, por, siç dihet, është



[18] Transmeton Ibën Hibbani në “Sahihun” e tij Er-Rekaik, kapitulli el-Edhkar 3/127, numër 847, dhe në senedin e tij është El Harith ibn Merixh En-Nikal. Ky është daif-i dobët, por edhe i akuzuar nga disa. Shiko “Ed Duafaul Kebir” 1/219, “Terxhemetu” 268, “Mizanul Iw’tidal” 1/433, numër 1619. Shejhu i El Harithit është Jahja ibn Jemani, për të cilin Ibn Haxheri thotë: “Saduk Abid-i drejtë, i devotshëm, gabon shumë dhe ka ndryshuar”, shiko “Et-Takrib” 598, “Et-terxhemetu” 7679, prandaj hadithi është daif-i dobët në sened dhe për këtë mjafton hadithi para tij.

[19] Ky është el-Imamul Al-lame El Hafidh Ebu Hatim Muhammed ibn Hibban ibn Ahmed ibn Hibban Et-Temimij El Bustij. Ka dalë në kërkim të diturisë dhe për të dëgjuar nga të tjerët. Ishte nga studiuesit e dalluar në diturinë e fikhut, gjuhës, hadithit dhe ligjërimit. Ishte nga njerëzit e mençur. Autor i shumë librave, si: “El Musnedus-Sahih”, “Eth-Thikatë”, “Et-Tarih” dhe “Ed-Duafa”, vdiq me 354 sipas kalendarit hixhrij (shiko për këtë “Tedhkiretul Hufadh” 3/920, “Sieru ealamin-Nubela” 16/92 dhe “Tabakatush-Shafi’ijeti” nga Es-Subkij 3/131).

[20] Shiko “Sahih Ibn Hibban” 3/128.

obligim për muslimanin të largohet nga kufri, mosbesimi dhe ithtarët e tij. Allahu subhanehu ve te ala thotë: *"Nuk gjen popull që e beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit e ta dojë atë që kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij..."* Muxhadele: 22

Për këtë arsye, disa nga shafijtë e kanë përmendur se nuk është e legjitimuar që gjatë vizitës në varrezat e jobesimtarëve të vizitohet ndonjë varr i veçantë^[21], nëse vizita bëhet për qëllim madhërimi dhe përluljeje ndaj të vdekurit në atë varr^[22]. Por është obligim për muslimanin që nëse i viziton varrezat e jobesimtarëve apo nëse i sheh ato, të ketë qëllim me këtë meditim rreth gjendjes së tyre dhe të ndiejë nevojën dhe varësinë e tij ndaj Allahut subhanehu ve te ala si dhe të shfaqë falënderimin ndaj Allahut për udhëzimin e tij në Islam.

Është transmetuar hadithi nga Ibën Umeri radijallahu anhuma, i cili ka thënë: *"Kur kaloi Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem afër vendbanimeve të popullit të Themudit, tha: "Mos hyni në vendbanimin e atyre që i bën padrejtësi vetes, që t'ju godasë ajo që i goditi ata, përveç nëse jeni duke qarë", pastaj ktheu kokën dhe shpejtoi të ecurit derisa e kaloi*

atë luginë^[23].

Nga ky hadith Neveviu ka titulluar një kapitull: Kapitulli mbi të qarit dhe frikën gjatë kalimit nëpër varrezat e zulumqarëve dhe nëpër vendbanimet e tyre si dhe shfaqjen e nevojës për Allahun dhe tërheqjen e vërejtjes nga neglizhenca ndaj kësaj.^[24]

Si përfundim: Nuk lejohet të shkuarit tek varrezat e jobesimtarëve për shëtitje dhe as për t'i madhëruar ato varre që madhërojnë jobesimtarët, por lejohet vizita e këtyre varreve me qëllim që të përkujtojmë vdekjen dhe të marrim mësim. Nëse vizita nuk bëhet për këtë arsye, atëherë nuk është e lejuar.

Vizita e jobesimtarit në varrin e muslimanit

Hanbelijtë kanë thënë se nuk i ndalohet jobesimtarit që të vizitojë varrin e të afërmit të tij musliman^[25] dhe kanë thënë se nuk ka gjë që e ndalon atë.^[26] Këtë mendim e ka zgjedhur edhe shejhul islam Ibn Tejmije rahimehullah.^[27]

Marrë nga libri "Abkamul Mekabir fish- Sheriatil Islamijeh"^[1]
nga Dr. Abdullah ibn Umer ibn Muhammed Es-Subejbanij
Përshtati: Adem Avdiu

[21] Shiko "Hashijetul Xhumel" 2/209 dhe "Hashijetush-Shervanij" 3/200.

[22] Shiko "Hashijetu Ibn Kasim El Abadij" 3/200.

[23] Transmeton Buhariu në librin "El Megazi", kapitulli Nuzulun-Nebij salallahu aljehi ve selem el Hixhr 3/1336, numër 4419, si dhe në kapituj të tjerë, Muslimi në librin "Ez-Zuhd ver-Rekaik", kapitulli La ted'hulu mesakinel-ledhine dhalemu enfusehum il-la en tekunu bakin 4/2285, numër 2980, Ahmedi 2/66 dhe të tjerë.

[24] Rijadus-Salihin 350, hadithi numër 962.

[25] Shiko "El furuë" 2/299 dhe "El mubdeu" 2/284.

[26] Shiko "Kishaful Kanai" 2/150.

[27] Shiko "El Ihtijaratul Fikhijeh" 90.

IMAM AHMEDI IBËN HANBELI ALLAHU E MËSHIROFTË

Alij ibën Medini, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Me të vërtetë Allahu i Lartësuar e ka ndihmuar këtë fe me dy persona, me Ebu Bekrin në “ditën e Rrides” dhe me Ahmed ibën Hanbelin në “ditën e Mihnes” (sprovës)

Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut të Lartësuar, i Cili në librin e Tij Famëlartë ka thënë: *“Allahu i ngre në shkallë të larta ata që besuan prej jush dhe ata që u është dhënë dije. Allahu është i njohur mirë me atë që punoni.”*^[1]

Përshëndetjet tona qofshin mbi të Dërguarin tonë, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili ka thënë: *“Atij që Allahu ia do të mirën, e bën që t’i kuptojë njohuritë e fesë.”*^[2]

Përshëndetjet tona qofshin edhe mbi familjen e tij të pastër, mbi shokët e tij të sinqertë dhe mbi të gjithë ata që pasuan dhe pasojnë rrugën e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Të shkruash për një dijetar si imam Ahmed, Allahu e mëshiroftë, është një nder i madh, sepse ai ishte një nga shëmbëlltyrat më të rëndësishme në ummetin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem pas sahabëve. Ai e ndriçoi këtë ummet me dritën e diturisë kur atë pothuajse e kishte kapluar errësira e injorancës së atyre që paso-

jnë mendjet dhe epsheet e tyre. Ai ishte imami i besimtarëve sa ishte gjallë dhe pas vdekjes së tij. E lusim Allahun e Lartësuar që ta mëshirojë me Mëshirën e Tij të pa-fund.

Imam Ahmed, Allahu e mëshiroftë, është njëri prej katër imamëve të katër medhhe-beve të njohura të Ehli Sunnetit. Imam Ahmed, Allahu e mëshiroftë, lindi në vitin 164h në qytetin e Bagdadit, në Irak. Që në fëmijërinë e tij u dallua dhe u shqua nga moshatarët e tij. E mësoi Kur’anin përmendësh në moshë shumë të re dhe e këndonte atë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Imam Ahmed, Allahu e mëshiroftë, që në moshë të re filloi të kërkonte dituri. Në fillim mori dituri nga dijetarët që ishin në vendin e tij, kurse më pas filloi të udhëtojë në kërkimin e diturisë nga dijetarët e vendeve të tjera islame, si në Mekë, Medinë, Basra, Jemen e kështu me radhë. Ai udhëtoi për në Basra më shumë se pesë herë duke kërkuar dituri nga dijetarët e hadithit, kurse drejt Hixhazit udhëtoi disa

[1] Muxhadele: 11.

[2] Transmeton Buhariu 71, Muslimi 1037.

herë. Nga dijetarët më të dalluar që takoi aty ishte imam Shafiu, Allahu e mëshiroftë. Nga ai i mori bazat në fushën e hadithit, fikhut dhe shumë njohuri të tjera. Ai përfitoi shumë nga ibën Ujejne, Allahu e mëshiroftë, i cili ishte nga dijetarët më të dalluar në kohën e tij. Shkoi të kërkojë dituri edhe në Jemen, në qytetin San'a, ku dëgjoi hadithe nga dijetari i nderuar Abdurr-Rrez-zak ibën Hem-mami, Allahu e mëshiroftë. Udhëtimet e tij në kërkimin e diturisë ishin të shumta, por edhe të mundimshme. Imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë, u përball me vështirësi të shumta në kërkimin e diturisë, në veçanti kur udhëtoi për në Jemen, mirëpo dashuria e tij për diturinë dhe në veçanti për kërkimin e hadithit e bëri atë të jetë gjithmonë i paluhatshëm në këtë qëllim dhe të përballojë çdo vështirësi që i paraqitej në rrugën e tij drejt diturisë. Këto vështirësi me të cilat përballlej imam Ahmedi ishin si parapërgatitje për një të ardhme të afërt, kur u sprovua me një sprovë shumë të madhe. Kjo sprovë ishte dalja në shesh e mendimit të grupimit el-mu'tezile, i cili përkrahej nga kalifi i muslimanëve në atë kohë. Mendimi i tyre ishte se Kur'ani nuk është fjala e Allahut të Lartësuar, por është i krijuar. Kjo vendosmëri e paluhatshme e imam Ahmedit bëri që i gjithë ummeti i Muhamedit alejhi salatu ve sel-lam të mbështetej tek ai kur ummetin e kishte kapluar kjo fitne e madhe dhe e pabazë, e cila nuk ishte tjetër vetëm se pjellë e atyre që pasonin logjikën dhe epshet e tyre duke lanë anash Sunnetin e pastër të të Dërguarit sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

[3] "Menakibul-Imam Ahmed", fq. 83.

[4] "Menakibul-Imam Ahmed", fq. 105.

[5] "Menakibul-Imam Ahmed", fq. 103.

[6] "Menakibul-Imam Ahmed", fq. 90.

Kërkuesit e dijeshme udhëtonin me kilometra të tëra për të dëgjuar nga imam Ahmedi qoftë edhe vetëm një hadith, sepse ishte nder për ta. Nga ai transmetonin hadithe edhe dijetarët me eminentë që njihje bota islame në atë kohë, si: Veki' ibën Xherr-rrah, imam Shafiu, Alij ibën Medini, Kutejbe ibën Seidi etj.

Fjalët e mësuesve të imam Ahmedit për të

1) Abdurrezzak ibën Hemmami, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Nuk kam parë askënd më të mençur dhe më të devotshëm se Ahmed ibën Hanbeli."^[3]

2) Muhamed ibën Alij, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "E kam dëgjuar Kutejbe ibën Seidin duke thënë: "Sikur të mos ishte Sufjan eth-Thevri, do të vdiste devotshmëria, por sikur të mos ishte Ahmed ibën Hanbeli, do të shpiknin në fe (bidatxhitë) çfarë të donin." Në një transmetim tjetër ka thënë: "Kur të vdesë Ahmed ibën Hanbeli, do të shfaqen bidatet."^[4]

3) Kutejbe ibën Seidi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Nëse shihni dikë që e do Ahmed ibën Hanbelin, atëherë dijeni se ai njeri është pasues i Sunnetit."^[5]

4) Ibrahim ibën Shemmas, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "E kam pyetur Veki' ibën Xherr-rrahun për Harixhetu ibën Mus'abin, që të na transmetojë hadithe nga ai. Ai më tha: "Unë nuk transmetoj nga ai, më ka ndaluar Ahmed ibën Hanbeli që të transmetoj nga ai."^[6]

5) Hisham ibën AbdulMelik et-Tajalisij, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Nuk ka në Basra e as në Kufe njeri që është më i

dashur dhe më i respektuar prej meje sesa Ahmed ibën Hanbeli.”^[7]

Fjalët e moshatarëve të tij për diturinë e imam Ahmedit

1) Imam Shafu, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Nuk kam parë më të mençur se dy persona: Ahmed ibën Hanbeli dhe Sulejman ibën Davud el-Hashimi.”^[8]

2) Alij ibën Medini, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Me të vërtetë Allahu i Lartësuar e ka ndihmuar këtë fe me dy persona, me Ebu Bekrin në “ditën e Rrides”^[9] dhe me Ahmed ibën Hanbelin në “ditën e Mihnes” (sprovës)^[10].”

3) Ishak ibën Rahevejhi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Ahmed ibën Hanbeli është argument mes Allahut dhe robërve të Tij në tokë.”^[11]

Mësuesit e tij

Imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë, që në moshë të re filloi të kërkojë dituri dhe për këtë arsye dijetarët nga të cilët mori dituri ishin të shumtë, mirëpo ne do të përmendim vetëm disa prej tyre:

- 1) Ab-bad ibën Ab-bad el-Muhel-lebij
- 2) Mu'temir ibën Sulejman et-Tejmij
- 3) Sufjan ibën Ujejneta el-Hilalij
- 4) Jahja ibën ebi Zaidete
- 5) Ebu Bekër ibën Aj-jash dhe shumë të tjerë, Allahu i mëshiroftë të gjithë.

Nxënësit e tij

Duke pasur parasysh diturinë e imam Ahmedit, Allahu e mëshiroftë, dhe pozitën e tij te dijetarët dhe kërkuarit e dijes, është shumë e natyrshme që ky imam të ketë qenë në vëmendjen e çdo kërkuari të dijes dhe çdokush prej tyre imagjinonte të ishte nga nxënësit e tij. Ky ishte një nder i madh për çdo kërkuar të dijes. Nga kjo kuptojmë se nxënësit që mësuan nga ai ishin të shumtë, mirëpo ne do të ndalemi vetëm disa prej tyre:

- 1) Abdall-llah ibën Abdurr-Rahman es-Semerkendij
- 2) Abdall-llah ibën Ahmed ibën Hanbeli (djali i imam Ahmedit)
- 3) Ebu Davud es-Sixhistanij (imam Ebu Davudi)
- 4) Muhammed ibën Ismail el-Buharij (imam Buhariu)
- 5) Jahja ibën Abdul-Humejd el-Himmanij, Allahu i mëshiroftë të gjithë.

Librat e tij

Muslimanët trashëguan një seri librash të shkruar nga imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë. Më voluminoz është “Musnedi” i tij, në të cilin përmbledoi afër tridhjetë mijë hadithe. Me këtë vepër ua lehtësoi rrugën kërkuarëve të dijes për grumbullimin e haditheve. Ndër të tjera ishin edhe këta libra:

- 1) Fadailus-Sahabe, i botuar në dy vëllime
- 2) El-ilel ve ma'rifeturr-Rrixhali, i botuar
- 3) El-esami vel-Kuna, i botuar
- 4) Kitabuz-Zuhd, i botuar
- 5) Err-Rred-du alaz-Zenadikah vel-Xheh-

[7] “Menakibul-Imam Ahmed”, fq. 91.

[8] “Menakibul-Imam Ahmed”, fq. 144.

[9] Kjo ishte pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kur disa fise arabe u kthyen në fenë e mëparshme dhe disa prej tyre nuk pranon ta jepnin zekatin.

[10] Qëllimi është fitneja e madhe në kohën e imam Ahmedit, Allahu e mëshiroftë, kur një grupim i devijuar, el-mu'tezile, thoshte se Kur'ani ishte i krijuar.

[11] “Menakibul-Imam Ahmed”, fq. 156.

mij-je, i botuar disa herë

6) Kitabul-Vukuf vel-Vesaja, i botuar

7) Ahkamun-Nisa, i botuar.

Disa fjalë të imam Ahmedit, Allahu e mëshiroftë

Imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë:

1) Bazat e Sunnetit për ne janë: kapja pas asaj që kanë qenë shokët e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe pasimi i tyre dhe lënia e bidateve (risive në fe), se çdo bidat është humbje...”^[12]

2) Abdallah et-Taresusi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “E kam dëgjuar Ahmed ibën Hanbelin duke thënë: “Mos i shoqëroni pasuesit e mendjeve edhe nëse e ndihmojnë Sunnetin (e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem).”^[13]

3) Fadël ibën Zijadi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “E kam dëgjuar Ahmed ibën Hanbelin duke thënë: “Kush e refuzon hadithin e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ai është në buzë të shkatërrimit.”^[14] ^[15]

4) Mejmuni, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Më tha mua Ahmed ibën Hanbeli: “Asnjëherë mos flit për ndonjë mesele (çështje në fe), përderisa nuk ke në të një imam (dijetar që të paraprin, që ka folur për këtë çështje para teje).”^[16]

5) “Nuk kam shkruar asnjë hadith pa vepruar me të, derisa edhe kur kam

shkruar (hadithin) se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e ka bërë hixhamen^[17] dhe i dha eba Tajbes një dinar, e kam bërë edhe unë hixhamen dhe i dhashë atij që ma bëri (hixhamen) një dinar.”^[18] Imam Ahmedi, Allahu e mëshiroftë, ndërroi jetë në ditën e xhuma të muajit Rrebiul-Ev-vel në vitin 241h. Në varrimin e tij morën pjesë mbi njëqind mijë xhematlinj. Vdekja e tij ishte një tronditje e madhe për ummetin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Neve nuk na mbetet tjetër vetëm se t'i lutemi Allahut të Lartësuar me emrat e Tij të bukur dhe me cilësitë e Tij të larta që ta mëshirojë këtë dijetar me Mëshirën e Tij, e cila është e pafund, dhe të na bashkojë ne dhe atë në xhennetin Firdevs me Pejgamberët, të sinqertët, dëshmorët dhe të mirët.

Përgatiti: Sabahudin Selimi

Literatura e konsultuar:

1) *Kur'ani i Madhëruar – Me përkthim të Sherif Ahmetit.*

2) *Sahihul-Buhari.*

3) *Sahihu Muslim.*

4) *“Menakibul-Imam Ahmed ibën Hanbel”, Ibni Xhevizj, Mues-sesetul-Hixhër, me verifikim të Abdulllah ibën Abdul-Muhsin et-Turkij.*

5) *“Sijer a'lam en-Nubela”, Shemsud-din ebu Abdillah Muhammed ibën Ahmed edh-Dhehebi, Mues-seseturr-rrisale. Një grup verifikues me mbikëqyrje të Shuajb Arnautit.*

6) *“Usulus-Sun-neh”, Ahmed ibën Hanbeli, Darul-Menar.*

[12] “Usulus-Sun-neh”, fq. 14.

[13] “Menakibul-Imam Ahmed”, fq. 210.

[14] Për fat të keq, të tillë në kohën tonë ka shumë, duke filluar nga muslimanët e thjeshtë e deri tek ata që e quajnë veten hoxhallarë. Ata kanë arritur deri në atë masë saqë nëse i kundërshton bidatet e tyre, qoftë edhe me hadithe nga “Sahihu” i Buhariut dhe Muslimit, nuk i pranojnë, por vazhdojnë me bidatet që kanë trashëguar nga të parët e tyre. Përveç kësaj, edhe shpallës si njeri që po shpikë bidate (risi në fe).

[15] “Sijer a'lam en-Nubela” 11/297.

[16] “Sijer a'lam en-Nubela” 11/296.

[17] Hixhame quhet nxjerrja e gjakut të keq nga trupi. Është pjesë e mjekësisë së të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

[18] “Sijer a'lam en-Nubela” 11/296.